

---

## BULETIN INFORMATIV

---

MAJ 2026

AKADEMIA E SHKENCAVE  
E SHQIPËRISË

---



---

**Buletin mujor i aktiviteteve të  
Akademisë së Shkencave të  
Shqipërisë**

Maj, 2026

---

## Përmbajtje

<b>Aktivitet</b> .....	<b>6</b>
180-vjetori i lindjes së Naim Frashërit: Kumtesa dhe reflektime shkencore .....	7
U zhvillua konferenca shkencore për Ibrahim Rugovën: Trashëgimia e tij, fushë e hapur kërkimi për studiuesit .....	12
Mbahet takimi i tretë i Akademive të Shkencave të Shteteve Anëtare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi – BSEC .....	14
Bashkëpunimi akademik dhe kulturor Shqipëri–Çeki në fokus: mbështetje për botimin e studimit të albanologut Robert Dobra .....	16
Marrëveshje ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Rrjetit Akademik Shqiptar .....	18
Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet QSUNT-së dhe Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë ASHSH-së .....	19
Promovohet “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” në Universitetin e Shkodrës .....	22
U promovua “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” në Universitetin “Fan S. Noli” .....	23
Nisën në Prishtinë punimet e konferencës së III ndërkombëtare shkencore për burimet ujore dhe mbrojtjen e mjedisit .....	24
Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e simpoziumit ndërkombëtar mbi “Inteligjencën Artificiale në Arsimin e Lartë” .....	27
Konferencë ndërkombëtare për zbatimin e programeve të parandalimit të kancerit të bazuara në prova në Europë dhe më gjerë .....	29
<b>Institutet dhe komisione</b> .....	<b>32</b>
Studimet gjenetike në popullatat shqiptare: mundësitë, sfidat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar .....	33
Prof. dr. Rami Memushaj mbajti ligjëratën: “Pesha e parimit morfologjik dhe fonologjik në drejtshkrimin e gjuhës shqipe .....	36
Mbylli punimet konferenca ndërkombëtare për parandalimin e kancerit .....	37

U prezantua projekti: “Hartografimi dhe Dokumentimi i zonave me potencial arkeologjik të Lezhës (Lissus)” .....	39
Dr. Shafi Gashi prezanton të dhënat e reja mbi kulturën tumulare në Kosovë .....	41
U prezantua ligjërata e prof. dr. Tomorr Plangaricës për çështje problemore të gramatikës diskursive.....	43
Më datën 18 maj 2026, u mbajt sesiioni shkencor me tematikë “Shqipja në rrethanat e sotme digjitale” .....	45
Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e Konferencës Ndërkombëtare ICBE 2026 mbi Mjedisin e Ndërtuar dhe Gjeorreziqet.....	47
U zhvillua workshop-i EduMat 2026 me temën “Edukimi Matematik në Epokën e STEM dhe Teknologjisë” .....	49
<b>Promovime .....</b>	<b>52</b>
U mbajt konferenca shkencore për promovimin e kolanës së botimeve shkencore të akademikut Rexhep Meidani.....	53
Akademiku Matteo Mandalà boton në Itali monografinë “Nel nome di Luigi Pirandello e gli Arbëreshë” .....	57
Akademia e Shkencave e Shqipërisë promovoi trilogjinë muzikologjike të autores Kristina Palokaj-Perkola .....	59
Promovohet libri i akademikut Vasil S. Tole për Laver Bariun dhe trashëgiminë e sazeve.....	62
<b>Të tjera.....</b>	<b>65</b>
Kujtojmë në ditën e lindjes Heroin Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun .....	66
Akademia e Shkencave uron 90-vjetorin e lindjes së akademikun Muzafer Korkuti..	68
Akademia e Shkencave nderon në 90-vjetorin e lindjes anëtarin dhe ish-kryetarin e saj, akademik Myzafer Korkuti .....	70
“Studimet mbi ADN e hershme rikonfirmojnë autoktoninë e shqiptarëve” .....	73
Shkenca në dialog me politikëbërjen për të formësuar të ardhmen strategjike të Europës .....	75
Akademik Nazim Gruda vlerësohet në Greqi me medaljen e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën Hortikulturore (ISHS) .....	76
Akademiku Nazim Gruda zgjidhet kryetar i Seksionit për Prodhimin në Sera dhe Mjedisë të Kontrolluara të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës .	78

---

Përfaqësueset e Albanian Young Academy në Takimin Evropian të Akademive të të Rinjve në Warsaw .....	80
Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Biologjik: ruajtja e tij një përgjegjësi e përbashkët që na lidh në misionin për një të ardhme të sigurt dhe të begatë për çdo gjallesë në Tokë.....	82
Dita Ndërkombëtare e Muzeve – hapësira që i shërbejnë zhvillimit të shkencës dhe shoqërisë .....	83
Dita Kombëtare e Drejtësisë.....	85
Urime për ditëlindjet e personaliteteve të shquara të shkencës, kulturës dhe arsimit	86
<b>In memoriam.....</b>	<b>87</b>
Veprimtaria përkujtimore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë muajit maj.	88

---

# **Aktivitet**

## 180-vjetori i lindjes së Naim Frashërit: Kumtesa dhe reflektime shkencore



Më 26 maj 2026, me rastin e 180-vjetorit të lindjes së Naim Frashërit, poetit kombëtar dhe një prej themeluesve të letërsisë moderne shqiptare, Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizoi një veprimtari shkencore jubilarë.

Synimi i kësaj veprimtarie ishte që, përmes kumtesave të akademikëve dhe studiuesve të njohur, të vlerësoheshin dimensionet filozofike, letrare dhe mistike të krijimtarisë së Naim Frashërit. Takimi u hap me përshëndetjen e Kryetarit të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSHSHA), akad. Gëzim Hoxha. Ai e cilësoi Naim Frashërin si një nga themeluesit më të rëndësishëm të ndërgjegjes kombëtare, të kulturës moderne dhe të gjuhës letrare shqipe. Gjithashtu, ai theksoi se përvjetorë të tillë shërbejnë jo vetëm për të kujtuar figura historike, por edhe për të reflektuar mbi themelet shpirtërore dhe

intelektuale të kombit shqiptar. Akad. Hoxha nënvizoi dimensionin filozofik dhe humanist të Naim Frashërit, duke e paraqitur atë si një figurë që harmonizoi dijen me besimin, traditën me modernitetin dhe ndjenjën kombëtare me tolerancën fetare. Sipas tij, Naimi mbetet një figurë unifikuese e kulturës shqiptare dhe një model i qytetarisë intelektuale.



Në përfundim, ai vlerësoi rëndësinë e veprimtarisë dhe të kumtesave shkencore që trajtojnë aspekte të ndryshme të veprës së Naimit, si mistika, bektashizmi, filozofia dhe ndikimi i tij në kulturën moderne shqiptare, duke shprehur mirënjohje për organizatorët dhe studiuesit pjesëmarrës.

Veprimtaria vijoi me kumtesën e akad. Albert Doja, i cili trajtoi pikëpamjet mbi dualizmin dhe panteizmin filozofik, duke u ndalur te zgjedhja e Naimit për t'u afruar me bektashizmin në kontekstin e nacionalizmit të shekullit XIX. Interpretime të shtjelluara mbi veprat e Naim Frashërit u dhanë në vijim në lidhje me këtë argument të përzgjedhur për trajtim.



Prof. asoc. Evalda Paci, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, ASHSH u paraqit me kumtesën “Naim Frashëri, një figurë monumentale e historisë së letërsisë shqipe”. Ajo e vlerësoi atë jo vetëm si poet të Rilindjes Kombëtare, por edhe si intelektual, patriot, autor tekstesh mësimore dhe kontribuues në themelimin e shtypit shqiptar. Veprimtaria e tij lidhet ngushtë me edukimin kombëtar dhe përhapjen e gjuhës shqipe, ndërsa figura e tij ka qenë vazhdimisht e pranishme në tekstet shkollore dhe në historitë e letërsisë shqipe. Eqrem Çabej, në veprën *Elemente të gjuhësisë dhe të literaturës shqipe* (1936), e cilëson Naim Frashërin si “apostull të idesë nacionale”.

Një aspekt i rëndësishëm i krijimtarisë së Naimit është përpjekja për të sjellë në shqip kryevepra të letërsisë klasike, veçanërisht Iliadën e Homerit. Kjo dëshmon rëndësinë që ai i jepte edukimit përmes letërsisë klasike dhe synimin që nxënësit shqiptarë të njihnin gjuhën amtare përmes veprave madhore botërore. Analiza e përkthimit të këngës së parë të Iliadës nxjerr në pah aftësinë e tij për të përshtatur figurat, epitetet dhe botën

mitologjike greke në gjuhën shqipe. Kjo përpjekje përbën një hap të rëndësishëm në historinë e përkthimit dhe të zhvillimit të shprehësisë së shqipes.

Prof. asoc. Viola Isufaj nga Universiteti i Tiranës u ndal te mistika si themel i vizionit poetik të Naim Frashërit. Ajo e vlerësoi atë si përfaqësues të bektashizmit, duke e parë mistikën si bazë të mendimit dhe krijimtarisë së tij. Edukimi i hershëm në teqenë bektashiane i dha poetit një bazë morale dhe shpirtërore mbi të cilën ndërtoi krijimtarinë e tij. Doktrina bektashiane, e mbështetur mbi dashurinë, vëllazërinë dhe besën, u ndërthur me ndikimet e iluminizmit perëndimor, duke i dhënë veprës së Naimit një karakter unik, ku tradita dhe moderniteti bashkekzistojnë në mënyrë harmonike.



---

Në vijim, dr. Ermira Alija nga Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” analizoi sakralitetin dhe pushtetin në veprën “Qerbelaja”, duke e interpretuar si ndërthurje mes thelbit fetar dhe instrumentalizimit të fesë. Ajo u ndal te kjo poemë e Naim Frashërit, duke e ndërtuar analizën mbi kontrastin moral mes figurave që sakrifikojnë për besimin dhe atyre që e përdorin fenë si instrument pushteti.

Dr. Fatos Dibra e vendosi Naim Frashërin në qendër të traditave letrare, duke u ndalur te përkthimi i Iliadës (këngës së parë të saj) në shqip dhe turqisht. Ai theksoi se ky akt nuk ishte thjesht një përkthim letrar, por një ndërmarrje kulturore që e afroi letërsinë klasike me kulturën shqiptare dhe e vendosi atë në dialog me botën orientale të shekullit XIX.

Botuesi i veprave të Naim Frashërit, Mehmet Gëzhilli (Argeta LMG), foli për rëndësinë e botimit të veprave të tij dhe për pasurimin e kolanave botuese me prurje të reja studimore. Punimet e veprimtarisë shkencore “Naim Frashëri në 180-vjetorin e lindjes” u mbyllën me diskutime dhe reflektime mbi trashëgiminë e tij komplekse si simbol i kulturës dhe identitetit kombëtar.

## U zhvillua konferenca shkencore për Ibrahim Rugovën: Trashëgimia e tij, fushë e hapur kërkimi për studiuesit



Më 14 maj 2026, Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë organizuan konferencën shkencore ndërkombëtare “Ibrahim Rugova - shkrimtari, intelektual, presidenti”.

Konferenca synoi të trajtojë në mënyrë ndërdisiplinore figurën e Ibrahim Rugovës, duke ndriçuar dimensionin e tij letrar, filozofik, kulturor dhe politik, si një prej figurave më të rëndësishme të historisë moderne shqiptare.

Këshilli organizues i konferencës përbëhej nga akad. Sabri Hamiti, në cilësinë e kryetarit, ndërsa anëtarë ishin akad. Gëzim Hoxha, akad. Rexhep Ismajli dhe akad. Marenglen Verli. Sekretar i konferencës ishte Nysret Krasniqi.

Në fjalën e hapjes, kryetari i Këshillit Organizues, akad. Sabri Hamiti, u shpreh se jeta dhe vepra e Rugovës paraqesin një rrugëtim të veçantë intelektual, që nis nga formimi familjar dhe letrar për të kaluar më pas në dimensionin politik dhe shtetformues. Sipas tij, Rugova kaloi nga fazat e hershme të shkrimit dhe hulumtimit shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës deri te ndërtimi i autoritetit të tij letrar e filozofik dhe, më pas, në rolin e prijësit të rezistencës politike të Kosovës.

Më tej, veprimtaria u përshëndet nga kryetarja e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të

---

Kosovës, akad. Justina Shiroka-Pula, e cila vlerësoi figurën dhe kontributin e Ibrahim Rugovës, duke theksuar se, në 20-vjetorin e ndarjes së tij nga jeta, nuk përkujtohet vetëm një individ, por një epokë dhe një vizion politik e kulturor. Ajo nënvizoi se Rugova ishte studiues i letërsisë, personalitet me horizont të gjerë evropian dhe pjesë e brezit të intelektualëve që e kuptuan se liria dhe shteti ndërtohen jo vetëm me forcë politike, por edhe me ide, kulturë dhe dije historike. Sipas saj, në periudhën më të vështirë për Kosovën, ai u shndërrua në zërin e popullit dhe simbol të rezistencës paqësore, duke arritur ta bëjë çështjen e Kosovës pjesë të ndërgjegjes ndërkombëtare. Ajo shtoi se, si presidenti i parë i Republikës së Kosovës, Rugova mbetet një nga figurat kyçe të shtetndërtimit modern të vendit.

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u lexua fjala e përgatitur nga akad. Gëzim Hoxha. Në fjalën e lexuar nga akad. Marenglen Verli, Rugova vlerësohej si një personalitet me ndikim të madh në jetën kulturore dhe politike shqiptare. Më tej theksohej se organizimi i përbashkët i konferencës nga dy akademitë përbënte jo vetëm një akt kujtese dhe nderimi në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta të Rugovës, por edhe dëshmi të vazhdimësisë së dialogut shkencor e kulturor mbarëkombëtar. Sipas Verlit, kjo figurë arriti të bashkojë mendimin kritik me përgjegjësinë historike dhe të ndërtojë një trashëgimi që nis me formimin e tij si studiues i letërsisë dhe kulmon me rolin e prijësit shtetformues.

Në konferencë, studiues nga Kosova, Shqipëria dhe vende të tjera trajtuan aspekte të ndryshme të jetës, mendimit kritik, filozofisë politike dhe rolit historik të Ibrahim Rugovës në proceset shtetformuese të Kosovës. Në veprimtari referuan nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë: akad. Marenglen Verli me kumtesën "Ibrahim Rugova dhe momenti historik"; akad. Shaban Sinani me temën "Ibrahim Rugova në Tiranë"; z. Andreas Dushi me kumtesën "Bogdani në studimet e Rugovës: shtigje për kërkime të mëtejshme"; prof. asoc. dr. Marenglen Kasmi me temën "Ndërmjet vizitave në Shqipëri dhe survejimit: Ibrahim Rugova në raportet e Sigurimit të Shtetit"; prof. Afrim Krasniqi me trajtesën "Ndikime dhe autonomi strategjike: Rugova dhe ndërveprimi me elitat politike shqiptare gjatë tranzicionit (1990–2006)"; prof. dr. Virion Graçi me temën "Kryezoti i kryqëzuar në ligjërimin ditor-politik dhe shenjtërimi në histori, në letërsi"; si dhe prof. asoc. dr. Evalda Paci me kumtesën "Një vështrim kritik, përmbajtësor dhe tekstori i veprës së Pjetër Bogdanit nga Ibrahim Rugova".

Punimet e konferencës vunë në pah rëndësinë e vazhdueshme të figurës së Ibrahim Rugovës në jetën politike, kulturore dhe intelektuale shqiptare, ndërsa trashëgimia e tij u vlerësua si një fushë e hapur studimi për kërkime të mëtejshme shkencore.

## Mbahet takimi i tretë i Akademive të Shkencave të Shteteve Anëtare të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi - BSEC



Akademia e Shkencave e Shqipërisë përfaqësuar nga akad. Neki Frashëri, kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike dhe akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike mori pjesë në takimin e tretë të Akademive të Shkencave të shteteve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BSEC). Ky aktivitet u mikprit dhe u organizua nga Akademia Bullgare e Shkencave në bashkëpunim me BSEC.

Takimi i mbajtur sot me 15 maj 2026 në Sofje, pati si temë qendrore: “Inteligjenca Artificiale si katalizator për bashkëpunimin shkencor në rajonin e BSEC”. Qëllimi i këtij organizmi ishte forcimi i bashkëpunimit ndërakademik, koordinimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, rritjes së rolit të shkencës në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe hartimit të politikave publike në rajon.

Përfaqësuesit e ASHSH-së, akad. Neki Frashëri dhe akad. Gëzim Hoxha trajtuan temën; “Inteligjenca Artificiale si katalizator për bashkëpunimin shkencor në rajonin e BSEC: rasti i Shqipërisë”. Gjatë prezantimit fokusi kryesor u vendos tek zhvillimet kryesore në fushën e Inteligjencës Artificiale në Shqipëri, krijimi dhe veprimtaria e Njesisë Kërkimore për IA pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, si dhe iniciativat akademike, konferencat dhe projektet kërkimore të realizuara në bashkëpunim me universitetet dhe institucionet shkencore në vend dhe në rajon.

Në prezantim u theksua se Inteligjenca Artificiale dhe Përpunimi i Gjuhës Natyrore po shndërrohen në mjete strategjike për arsimin, kërkimin shkencor, inovacionin dhe zhvillimin ekonomik. U prezantuan disa nga aktivitetet kryesore të organizuara nga

---

Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitet e fundit, ndër to forumi shkencor mbi Inteligjencën Artificiale i vitit 2023, konferenca ndërkombëtare “AI Horizon – A New Era of Creativity and Innovation”, e zhvilluar në Tiranë në nëntor 2024, si dhe projektet kërkimore në fushën e teknologjive inteligjente, arsimit digjital dhe aplikimeve të IA-së në turizëm dhe vendimmarrje. Ligjërata evidentoi nevojën për krijimin e platformave të përbashkëta rajonale të kërkimit, të infrastrukturave të përbashkëta shkencore dhe të standardeve të përbashkëta etike, në përputhje me praktikën e Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërmjet akademive, universiteteve, institucioneve publike dhe sektorit privat për ta shndërruar Inteligjencën Artificiale në një faktor të progresit të qëndrueshëm dhe zhvillimit rajonal.

Takimi mbledhi presidentët dhe përfaqësuesit e Akademive të Shkencave të vendeve anëtare të BSEC, ku bën pjesë Shqipëria dhe shërbeu si një platformë strategjike për dialog, shkëmbim përvojash dhe identifikim të nismave të përbashkëta kërkimore.

Pjesëmarrja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në këtë aktivitet ka rëndësi të veçantë institucionale dhe përfaqësuese, duke kontribuar në forcimin e rolit të saj në kuadër të bashkëpunimit rajonal shkencor dhe akademik.

## Bashkëpunimi akademik dhe kulturor Shqipëri-Çeki në fokus: mbështetje për botimin e studimit të albanologut Robert Dobra



Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole, priti në një takim zëvendësambasadoren e Republikës Çeke në Shqipëri, znj. Irena Žizka dhe albanologun çek Robert Dobra.

Takimi u zhvillua në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe institucioneve kërkimore-shkencore të Republikës Çeke, si dhe konsolidimit të marrëdhënieve akademike e kulturore mes dy vendeve.

Në fokus ishte mbështetja për studimin dhe botimin e veprës së albanologut Robert Dobra, “Albania in Czech Visual Memory” (“Shqipëria në kujtesën vizuale çeke”), një nismë e ndërmjetësuar nga Ambasada e Republikës Çeke në Shqipëri.

ASHSH dhe Qendra e Studimit të Artit pranë saj do të krijojë të gjitha lehtësirat e duhura për mbështetjen e hulumtimeve, përgatitjen dhe botimin e këtij studimi të rëndësishëm i cili fokusohet në trashëgiminë e arteve pamore të autorëve çekë, mbi Shqipërinë dhe shqiptarët.

Studimi vlerësohet si një kontribut i rëndësishëm në albanologji dhe në pasurimin e

---

studimeve mbi Shqipërinë në një perspektivë ndërkombëtare.

Për më shumë lexoni linkun:

<https://albaniabohemica.cz/sq/...>

## Marrëveshje ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Rrjetit Akademik Shqiptar



Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), më 7 maj 2026, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi që përcakton kuadrin institucional të partneritetit në fushën e infrastrukturës digjitale dhe shërbimeve mbështetëse për publikimet akademike.

Marrëveshja u firmos nga Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi dhe Drejtori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Bordit të RASH-it, dr. Arjan Xhelaj.

Ky bashkëpunim synon krijimin, zhvillimin, mirëmbajtje dhe administrimin teknik të portalit të revistave shkencore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë, si institucioni më i lartë shkencor në vend, dhe RASH, si struktura përgjegjëse për zhvillimin dhe administrimin e infrastrukturës teknologjike dhe rrjeteve akademike, bashkëpunojnë për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe modern të platformës së revistave shkencore dhe rritjen e cilësisë së publikimeve akademike në Republikën e Shqipërisë.

RASH kontribuon gjithashtu në mirëmbajtjen e infrastrukturës digjitale në shërbim të arsimit dhe shkencës, duke siguruar ndërlidhjen e rrjetit akademik shqiptar me rrjetin evropian GÉANT.

Nënshkrimi i këtij akti përbën një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të shërbimeve akademike dhe konsolidimit të infrastrukturës së publikimeve shkencore.

## Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet QSUNT-së dhe Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës pranë ASHSH-së



Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGJ), pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUNT) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me rëndësi për forcimin e kapaciteteve kërkimore-shkencore dhe diagnostikuese në vend, referuar VKM 298, dt 15.5. 2024, pika 4, “Për ngritjen e Qendrës Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës”.

Ceremonia e nënshkrimit u zhvillua në praninë e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, si dhe të anëtarëve të Kryesisë së ASHSH-së. Marrëveshja u nënshkrua nga Drejtoresha e Përgjithshme e QSUNT-së, znj. Anxhela Paparizo, Drejtori i QKBGJ-së, akad. Genc Sulçebe, si dhe Kancelari i Akademisë së Shkencave, z. Ruzhdi Kuçi.

Kryetari i ASHSH falenderoi drejtoreshën e QSUNT për frymën e bashkëpunimit dhe i garantoi mbështetjen e ASHSH për aktivitete të përbashkëta mes dy institucioneve. Në fjalën e tij, akad. Skënder Gjinushi theksoi rëndësinë e krijimit dhe konsolidimit të njëjësive kërkimore, të përhershme dhe të përkohshme, në kuadër të ligjit të ri të Akademisë së Shkencave. Ai vlerësoi aktivitetin e deritanishëm të qendrave kërkimore të përkohshme, duke nënvizuar se Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës është krijuar në

periudhën e pandemisë COVID-19.

Gjithashtu, ai u shpreh se fusha e bioteknologjisë dhe gjenetikës ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishëm në zhvillimin shkencor, duke nënvizuar se qendrat konceptohen që të jenë pranë Akademisë së Shkencave, si Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës që është një bashkëpunim mes Universitetin të Tiranës, Universitetit të Mjekësisë, QSUNT-në dhe Universitetit Bujqësor. Sipas tij, qendra, e cila prej rreth dy vitesh funksionon si një njësi e përhershme mund të konsiderohet tashmë një institut i vogël kërkimor i bazuar në projekte.



Drejtoresha e QSUNT-së nga ana tjetër shprehu mirënjohjen për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë për këtë bashkëpunim të rëndësishëm dhe vizionar. Ajo e vlerësoi nënshkrimin e marrëveshjes me Qendrën Kërkimore të Bioteknologjisë dhe Gjenetikës si një hap të rëndësishëm për forcimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e diagnostikës moderne në QSUNT.

Qëllimi i marrëveshjes është rregullimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe përcaktimi i kushteve të bashkëpunimit për përdorimin e infrastrukturës mbështetëse të QSUNT-së nga QKBGJ-ja, si dhe shfrytëzimi i ndërsjellë i kapaciteteve shkencore, laboratorike dhe diagnostikuese në funksion të interesit të përbashkët institucional.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, ambientet e ish-Labororit Imunologjik pranë QSUNT-së, të vendosura në godinën e Spitalit të Sëmundjeve të Brendshme, së bashku me pajisjet dhe asetet ekzistuese sipas inventarit përkatës, do t'i vihen në dispozicion

---

Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për përdorim të përkohshëm dhe për qëllime kërkimore-shkencore.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin e infrastrukturës kërkimore dhe në avancimin e kërkimit shkencor në fushën e bioteknologjisë dhe gjenetikës në Shqipëri.



## Promovohet “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” në Universitetin e Shkodrës



Cikli i promovimeve të veprës madhore “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” ka vijuar sot më 21 maj 2026 në Universitetin “Luigj Gurakuqi” të Shkodrës.

Synimi i kësaj veprimtarie ishte që akademikë, pedagogë të gjuhësisë dhe albanologjisë, të diskutojnë për sfidat e gjuhës shqipe në epokën digjitale dhe pasurinë leksikore të të folmeve veriore të pasqyruara në fjalorin e ri.

Në fjalën e tij, Kryetari i Akademisë së Shkencave, akademik Skënder Gjinushi, e cilësoi fjalorin si një arritje madhore dhe një amanet të gjuhëtarëve ndër breza. Ai vlerësoi veçanërisht dialektet e pasura të shqipes, duke theksuar se ato nuk e konkurrojnë gjuhën standarde, por e pasurojnë atë. Akad. Gjinushi nënvizoi se vepra është rezultat i një pune të gjerë shkencore, ku morën pjesë dhjetëra bashkautorë e hartues, dhe se ky botim plotëson një boshllëk historik, duke e vendosur shqipen në nivelin e gjuhëve të mëdha me fjalorë të tillë.

Veprimtaria u shoqërua me kumtesa e diskutime të frytshme, duke e vënë në dukje rolin e fjalorit si një bazë e domosdoshme për studimet e ardhshme dhe si një mjet i rëndësishëm për studentët, studiuesit dhe brezat e rinj, në ruajtjen e identitetit gjuhësor dhe pasurimin e mëtejshëm të albanologjisë.

## U promovua “Fjalori i madh i gjuhës shqipe” në Universitetin “Fan S. Noli”



Sot, në datën 11 maj 2026, në Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës u promovua projekti madhor i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë “Fjalori i madh i gjuhës shqipe”.

Në këtë veprimtari morën pjesë sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave akad. Anila Hodo; drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë pranë ASHSH-së, akad. Valter Memisha, si dhe anëtarë të redaksisë së hartimit të fjalorit.

“Fjalori i madh i gjuhës shqipe” përfaqëson një arritje të rëndësishme të leksikografisë shqiptare, me vlera të veçanta shkencore, akademike dhe arsimore. Ai shërben si një burim i rëndësishëm reference për studiuesit, pedagogët, mësuesit dhe studentët, si dhe për të gjithë ata që kontribuojnë në zhvillimin, standardizimin dhe pasurimin e gjuhës shqipe.

## Nisën në Prishtinë punimet e konferencës së III ndërkombëtare shkencore për burimet ujore dhe mbrojtjen e mjedisit



Sot, më 28 maj 2026, ka nisur punimet konferenca e III-të ndërkombëtare shkencore dyditore me temë: “Uji si burim i energjisë dhe mbrojtja e mjedisit: Balanca drejt së ardhmes së qëndrueshme”. Kjo veprimtari organizohet në kuadër të bashkëpunimit institucional ndërmjet Akademisë së Shkencave e të Arteve e Kosovës (ASHAK) dhe Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (ASHSH).

Konferenca ka bërë bashkë akademikë, studiues të njohur, ekspertë të fushës dhe përfaqësues të institucioneve kryesore shkencore e universitare nga Kosova dhe Shqipëria. Ndër personalitetet e shquara të pranishme në këtë aktivitet ishte edhe ish-kryeministër i Kosovës Isa Mustafa.

Në hapje të konferencës, të pranishmit u përshëndetën nga zëvendëskryetari i ASHAK-ut, akad. Fejzullah Krasniqi dhe nga dy bashkëorganizatorët e këtij aktiviteti, akad. Fetah Podvorica (ASHAK) dhe akad. Besnik Baraj (ASHSH), të cilët vlerësuan lart bashkëpunimin ndërakademik dhe rëndësinë e trajtimit të përbashkët të sfidave mjedisore në hapësirën mbarëshqiptare.

Në fjalën e tij përshëndetëse, akad. Besnik Baraj vuri në dukje se raporti midis ujit, energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit përbën një trekëndësh themelor për të ardhmen e

---

qëndrueshme të shoqërive tona.

"Uji sot nuk përfaqëson më vetëm një pasuri natyrore; ai është një element kyç për energjinë, bujqësinë, biodiversitetin, qëndrueshmërinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe mirëqenien e qytetarëve tanë. Zgjidhjet ndaj sfidave mjedisore nuk mund të jenë thjesht kombëtare; ato duhet të jenë ndërkombëtare dhe ndërdisiplinore," u shpreh ndër të tjera akad. Baraj.

Më tej, ai propozoi që ky bashkëpunim të shërbejë si bërthamë për një platformë më të gjerë ballkanike dhe nxiti institucionet kërkimore të dy vendeve për aplikime të përbashkëta në programet europiane si Horizon Europe, Interreg, IPA dhe Green Agenda for the Western Balkans, duke synuar projekte të përbashkëta, rrjete të përhershme ekspertize dhe shkëmbime të studiuesve të rinj.

Qëllimi kryesor i këtij takimi ndërkombëtar është diskutimi i qasjeve shkencore mbi menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore, zhvillimin e energjisë së rinovueshme, mbrojtjen e ekosistemeve mjedisore, si dhe aplikimin e teknologjive inovative për monitorimin dhe trajtimin e ndotësve në ujë.

Tematikat kryesore të punimeve të konferencës, përfshijnë burimet ujore dhe potencialin energjetik në rajon, energjitë e rinovueshme dhe strategjitë për ruajtjen e energjisë, teknologjitë e avancuara për trajtimin e ujit dhe eliminimin e ndotësve, si dhe menaxhimin e integruar të ujërave në funksion të një zhvillimi të qëndrueshëm.

Prof. Zydi Teqja, anëtar i Njesisë "Pasuritë ujore" pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë mbajti referencën kryesore.

Në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore të kësaj njësie, u paraqitën kumtesat dhe rezultatet e studimeve nga akad. Besnik Baraj, prof. Adem Bekteshi, prof. Valbona Kolaneci, prof. Amilda Ballata, dr. Rozarta Nezaj, prof. Edlira Tako, dr. Orjada Hyska, dr. Ervis Krymbi dhe msc. Ana Ameda. Gjithashtu trajtuan tema që lidhen me ndërlidhjen ujë-energji, monitorimin e ndotjes së ujërave dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Prof. Majlinda Daci paraqiti kumtesën mbi vulnerabilitetet strukturore dhe tranzicionin energjetik në Kosovë, ndërsa prof. Avdulla Alija dhe dr. Fisnik H. Asllani trajtuan çështjen e monitorimit dhe biomonitorimit të ndotjes së ujit në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjithashtu, u prezantuan studime mbi përcaktimin e kushteve të referencës në përroin e Qarrishtës nga prof. Valbona Kolaneci dhe bashkëautorët, si dhe mbi vlerësimin ekologjik të pelljeve të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës nga prof. Linda Grapci-Kotori dhe ekipi i saj kërkimor. Punimet vijuan me trajtimin e menaxhimit të risqeve kimike dhe biologjike të ujërave të lumit Devoll për përdorim bujqësor, si dhe me prezantimin e një sistemi elektronik inovativ "SMART" me bazë rGO për detektimin e metaleve të rënda në ujë, i zhvilluar në bashkëpunim ndërinstitutional nga studiues shqiptarë dhe të huaj.

---

Në vijim të punimeve të konferencës, u prezantuan studime të fokusuara në vlerësimin e cilësisë së ujërave, trajtimin e ndotjes dhe aplikimin e teknologjive inovative për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Prof. Halil Ibrahim, prof. Linda Grapci-Kotori dhe bashkëautorët paraqitën një studim mbi vlerësimin e cilësisë së ujit në pellgun e Ibrit në Kosovë, bazuar në makroinvertebrorët bentikë. Ndërkohë, prof. Rozarta Nezaj dhe ekipi i saj trajtuan menaxhimin e integruar dhe përdorimin efikas të ujit për reduktimin e ujërave të ndotura në industrinë e përpunimit të qumështit.

Një tjetër prezantim nga prof. Amilda Ballata dhe bashkëpunëtorët u fokusua në vlerësimin e cilësisë së ujit në rrytet e shpërndarjes, ndërsa prof. Bashkim Thaçi dhe studiues të tjerë prezantuan aplikimin e proceseve hibride për menaxhimin e joneve të manganit nga liqeni i Badovcit. Gjithashtu, u prezantua një studim ndërkombëtar mbi përdorimin e nanokompoziteve argjilë-oksid kobalti për largimin efikas të joneve të metaleve të rënda nga uji, si dhe një analizë mbi shkallën e eutrofikimit në liqenin artificial të Tiranës nga prof. Edlira Tako dhe bashkëautorët.

Punimet e konferencës do të vijojnë me 29 maj 2026 me platformën për rekomandimet politikëbërëse dhe strategjike në menaxhimin e pasurive ujore në hapësirën mbarëshqiptare.

## Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e simpoziumit ndërkombëtar mbi “Inteligjencën Artificiale në Arsimin e Lartë”



Në datat 11–12 maj 2026, në Ankara, Turqi, u zhvillua simpoziumi ndërkombëtar mbi “Inteligjencën Artificiale në Arsimin e Lartë”, i organizuar nga Akademia Turke e Shkencave (TÜBA) dhe Shoqata e Akademive dhe Shoqërive të Shkencave në Azi (AASSA), me mbështetjen e Partneritetit Ndërademik (IAP), në Universitetin e Shkencave Sociale të Ankarasë (ASBÜ).

Simpoziumi mbledhi së bashku përfaqësues të akademive, ekspertë dhe studiues nga Shqipëria, Azerbajxhani, Bangladeshi, India, Malajzia, Pakistani, Filipinet, Rumania, Serbia dhe Turqia.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë në këtë aktivitet u përfaqësua me akad. Ilirjan Malollari, i cili kontribuoi në diskutimet mbi integrimin e inteligjencës artificiale në arsimin e lartë, me fokus kryesisht në edukimin inxhinierik, kërkimin shkencor dhe inovacionin. Ai ndau gjithashtu njohuri mbi zhvillimet, mundësitë dhe sfidat aktuale në këtë fushë përmes prezantimit të tij me titull: “Artificial Intelligence in Education and Scientific Research: Trends, Challenges, and Opportunities – The Albanian Approach”.

---

Aktiviteti u përqendrua në diskutimin e rolit transformues të inteligjencës artificiale në arsimin e lartë dhe në vlerësimin e qasjeve bashkëpunuese ndaj sfidave të reja. Simpoziumi theksoi perspektivat ndërdisiplinore dhe bashkëpunimin rajonal për të promovuar përdorimin e përgjegjshëm dhe efektiv të IA-së në universitete dhe në institucione kërkimore. Diskutimet mbuluan një gamë të gjerë temash, duke përfshirë bashkëpunimin akademik në rajonin euromesdhetar, transformimin e sistemeve të arsimit të lartë në Evropë dhe në Azi, rolin e IA-së në shëndetësi, bujqësi, studimet mbi rrezikun dhe mjedisin, si dhe perspektivat e politikave kombëtare mbi integrimin e IA-së në universitete.

Simpoziumi u hap me fjalën përshëndetëse të Presidentit të TÜBA-s, prof. dr. Muzaffer Şeker; të Presidentit të AASSA-s dhe Anëtarit të Plotë të TÜBA-s, prof. dr. Ahmet Nuri Yurdusev.

Gjatë dy ditëve të aktivitetit u organizuan katër sesione tematike me titujt: “Qeverisja e IA-së, politikat dhe përshtatja strategjike në arsimin e lartë”, “Edukimi i ekspertëve të IA-së për ekonominë e dijes”, “Integrimi i IA-së në universitete: mundësi dhe sfida” dhe “Perspektiva rajonale dhe globale mbi IA-në në arsimin e lartë”.

Ndër prezantimet kryesore u veçuan ato të prof. dr. Muazzam Khattak nga Universiteti Quaid-i-Azam, Pakistan; prof. dr. Mohamed Hadi Habaebi nga Universiteti Ndërkombëtar Islamik i Malajzisë; prof. asoc. dr. Alina Andreica nga Universiteti Babeş-Bolyai, Rumani; dhe prof. dr. Alvin B. Culaba nga Akademia Kombëtare e Shkencës dhe Teknologjisë e Filipineve.

Simpoziumi nxiti me sukses dialogun ndërmjet ekspertëve nga rajone dhe disiplina të ndryshme dhe kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit akademik ndërkombëtar mbi të ardhmen e inteligjencës artificiale në arsimin e lartë. Një përmbledhje e abstrakteve të simpoziumit iu shpërnda të gjithë pjesëmarrësve, ndërsa punimet e plota do të botohen në një vëllim të veçantë me status të indeksuar.

## Konferencë ndërkombëtare për zbatimin e programeve të parandalimit të kancerit të bazuara në prova në Europë dhe më gjerë



Në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë nisi punimet konferenca ndërkombëtare me temën: “Towards large-scale adaptation and tailored implementation of evidence-based primary cancer prevention programmes in Europe and beyond” (Drejt adaptimit në shkallë të gjerë dhe zbatimit të përshtatur të programeve të bazuara në prova për parandalimin parësor të kancerit në Europë dhe më gjerë).

Konferenca u organizua në kuadër të takimit vjetor të Konsorciumit të projektit PIECES (një projekt evropian në kuadër të programeve HORIZON të mbështetura nga Bashkimi Evropian) dhe u mbështet nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në përputhje me misionin e saj për promovimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Në fjalën përshëndetëse, sekretarja shkencore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Anila Hoda, në emër të Kryesisë, theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti si një platformë për shkëmbimin e njohurive dhe për avancimin e bashkëpunimit ndër-institucional. Ajo nënvizoi rolin e komisioneve shkencore, veçanërisht të Komisionit të përhershëm të Mjekësisë, në zhvillimin e kërkimit ndërdisiplinor dhe në adresimin e sfidave me rëndësi për shoqërinë.

Në vijim, zëvendësministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Eugena Tomini, vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike dhe atyre akademike për integrimin e programeve të bazuara në prova në sistemin e kujdesit shëndetësor parësor, duke riafirmuar angazhimin institucional për mbështetjen e iniciativave në këtë fushë.



Ndërsa rektori i Universitetit të Mjekësisë, prof. dr. Xheladin Draçini, evidentoi rëndësinë e projektit PIECES si një nismë e financuar nga Bashkimi Europian dhe e zbatuar nga një konsorcium ndërkombëtar prej 15 partnerësh. Projekti synon rritjen e efektivitetit dhe shtrirjes së programeve të parandalimit parësor të kancerit përmes zhvillimit të mjeteve dhe udhëzimeve të bazuara në evidencë, duke kontribuar në forcimin e shkencës së zbatimit dhe në përmirësimin e përdorimit të burimeve në sistemet shëndetësore. Në ditët në vijim, punimet e konferencës përfshijnë sesione shkencore, prezantime mbi progresin dhe rezultatet e projektit, si dhe diskutime mbi sfidat dhe perspektivat e zbatimit të programeve të parandalimit. Një vëmendje e veçantë i kushtohet prezantimit

të rezultateve nga vendet pjesëmarrëse dhe diskutimeve mbi qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e ndërhyrjeve në nivel europian dhe më gjerë.



Aktiviteti synon të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në promovimin e politikave të bazuara në evidencë në fushën e shëndetit publik.

---

# **Institutet dhe komisione**

## Studimet gjenetike në popullatat shqiptare: mundësitë, sfidat dhe bashkëpunimi ndërkombëtar



Më 15 maj, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvillua simpoziumi shkencor me temën: “Mundësitë, sfidat dhe ndikimi i bashkëpunimeve në studimet gjenetike në popullatat njerëzore shqiptare”. Aktiviteti u organizua nga Qendra Kërkimore e Bioteknologjisë dhe Gjenetikës (QKBGJ), pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës, Universitetin e Mjekësisë, Universitetin e Sporteve të Tiranës, Institutin e Policisë Shkencore, Universitetin “Zoja e Këshillit të Mirë”, klinikën “Gliozheni” Tiranë, Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Universitetin e Prishtinës, si dhe studiues të tjerë të përfshirë në projektin “Rrënjët”.

Veprimtarinë e hapi akad. Ilia Mikerezi, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar në fushën e gjenetikës dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në Shqipëri.

Më pas, në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, sekretarja Shkencore e ASHSH-së akad. Anila Hoda, përshëndeti të pranishmit dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimeve shkencore ndërdisiplinore dhe ndërkombëtare. Ajo vuri në dukje se studimet gjenetike mbi popullatat shqiptare kanë vlerë të dyfishtë, pasi kontribuojnë në zgjerimin e njohurive mbi historinë dhe strukturën e popullatave njerëzore dhe njëkohësisht ndihmojnë në kuptimin më të thellë të diversitetit dhe sfidave shëndetësore në vend. Në mënyrë të zgjeruar ajo theksoi edhe rëndësinë e etikës shkencore dhe mbrojtjes së të dhënave personale në kërkimin gjenetik, si dhe rolin e këtyre bashkëpunimeve në forcimin e kapaciteteve akademike dhe integrimin e Shqipërisë në hapësirën shkencore evropiane dhe ndërkombëtare.



---

Në vijim, deputeti z. Eduart Shalsi vlerësoi rolin e shkencës në zhvillimin e vendit dhe ndikimin e drejtpërdrejtë të kërkimeve gjenetike në shëndetësi, diagnostikim dhe zhvillimin e bioteknologjisë, duke theksuar nevojën për forcimin e kuadrit ligjor dhe bashkëpunimit institucional.

Simpoziumi vijoi me prezantimet shkencore, ku prof. Garrett Hellenthal analizoi përdorimin e të dhënave gjenomike për rindërtimin e historisë njerëzore dhe për të kuptuar modelet e migrimit të popullatave.

Në vijim të seancës plenare prof. asoc. Alessio Boattini analizoi historinë gjenetike të komuniteteve arbëreshe dhe lidhjet e tyre me hapësirën shqiptare, ndërsa Gjergj Bojaxhi paraqiti hipotezat mbi vazhdimësinë ilire në formimin e popullatës shqiptare.

Akademik Ilia Mikerezi paraqiti rezultatet e kërkimeve lidhur me diversitetin e haplogrupeve Y-STR dhe strukturën e linjave atërore.

Dr. Raffaella Cascella prezantoi online korrelacionin gjenotip-fenotip në distrofite të trashëguara të retinës, ndërsa prof. Avdulla Alija analizoi sfidat e mësimdhënies së gjenetikës në Universitetin e Prishtinës.

Prof. asoc. Eliana Ibrahim trajtoi integrimin e të dhënave multiomike në diagnostikimin e sëmundjeve kardiovaskulare. Msc. Amanda Deda analizoi aplikimet forenzike të kromozomit Y përmes Yfiler Plus. Prof. Xheni Toska foli për rëndësinë klinike të mutacioneve të gjenit MTHFR në popullatën shqiptare, ndërsa prof. Irena Seferi trajtoi tipizimin gjenetik të antigjeneve eritrocitare, trombocitare dhe leukocitare me aplikime në mjekësinë transfuzionale.

Efektet e PGT-A në përzgjedhjen embrionale dhe rezultatet klinike u paraqitën nga sr. Emi Gliozheni, e cila analizoi efektet e PGT-A në përzgjedhjen embrionale dhe rezultatet klinike.

Prof. asoc. Adela Perolla trajtoi rolin e hematopoiezës klonale si urë mes plakjes, inflamacionit dhe sëmundjeve sistematike.

Në fund, nga msc. Lenida Suraj dhe msc. Blerina Rapo u paraqitën mospërputhjet fenotip-gjenotip në diagnostikimin e tuberkulozit rezistent ndaj barnave dhe zhvillimi i një mjeti të ri gjenetik për identifikimin e mikrobaktereve jo-tuberkulare.

Në konkluzionet përmbyllëse simpoziumi u vlerësua si një platformë e rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe avancimin e kërkimeve gjenetike në Shqipëri dhe rajon.

## Prof. dr. Rami Memushaj mbajti ligjëratën: “Pesha e parimit morfologjik dhe fonologjik në drejtshkrimin e gjuhës shqipe



Ligjëratata u mbajt sot më 22 maj 2026 në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me organizmin e Seksionit të Shkencave Shoqërore Albanologjike dhe Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pjesë e Akademisë së Shkencave Prof. dr. Rami Memushaj trajtoi çështjet themelore të ortografisë së shqipes, duke u ndalur te roli i parimit fonologjik dhe morfologjik në shkrimin e fjalëve. Ai paraqiti bazat teorike dhe praktike të drejtshkrimit të shqipes, duke e vënë theksin në rolin e dy parimeve themelore që e udhëheqin atë.

Në ligjëratë u shpjeguan konceptet bazë të ortografisë, grafemës dhe ortogramit, duke u ndalur te përputhja grafemë-fonemë (parimi fonologjik) dhe ruajtja e morfemës në shkrim pavarësisht ndryshimeve fonetike (parimi morfologjik). Përmes krahasimeve me gjuhë të tjera dhe literaturës ndërkombëtare, u theksua se drejtshkrimi i shqipes është një sistem i ndërmjetëm, ku veprojnë të dy parimet. Përmes analizave dhe përlllogaritjeve të bazuara në Fjalorin e vitit 2006, u theksua se parimi morfologjik ka peshën kryesore në drejtshkrimin e gjuhës shqipe, ndërsa parimi fonologjik mbetet ndihmës.

Gjithashtu, prof. dr. Memushaj solli edhe një diskutim të veçantë mbi shkrimin e zanores ë së patheksuar, si një “nyje problematike” e drejtshkrimit, ku bashkëveprojnë aspektet fonetike, morfologjike dhe semantike.

Pas mbylljes së ligjëratës veprimtaria u shoqërua me diskutime. Ligjëratata e prof. dr. Memushaj u vlerësua si një kontribut i rëndësishëm në debatin shkencor mbi drejtshkrimin e shqipes dhe zhvillimet e tij në kohë.

## Mbylli punimet konferenca ndërkombëtare për parandalimin e kancerit



Sot, më 8 maj 2026, në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u mbyllën punimet e konferencës ndërkombëtare treditore mbi parandalimin e kancerit me temën: “Towards large-scale adaptation and tailored implementation of evidence-based primary cancer prevention programmes in Europe and beyond” (Drejt adaptimit në shkallë të gjerë dhe zbatimit të përshtatur të programeve të bazuara në prova për parandalimin parësor të kancerit në Europë dhe më gjerë).

Konferenca u organizua në kuadër të konsorciumit PIECES (një projekt evropian në kuadër të programeve HORIZON të mbështetura nga Bashkimi Evropian) dhe me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Në këtë aktivitet morën pjesë 15 institucione kërkimore nga 10 vende të Bashkimit Evropian, si edhe nga Shqipëria dhe Ukraina, të cilat prezantuan progresin e arritur në eksperimentimin dhe zbatimin praktik të instrumenteve inovative në programet e shëndetit publik për parandalimin parësor të kancerit.

Gjatë konferencës u theksua se rreth 40% e rasteve të kancerit mund të parandalohen, por programet shëndetësore shpesh hasin vështirësi në zbatim. Në një botë që digjitalizohet

---

çdo ditë, instrumente si “It-Fits Toolkit” dhe bibliotekat digjitale të praktikave efektive mund të ndihmojnë profesionistët e shëndetit publik në të gjitha fazat e hartimit dhe zbatimit të projekteve për parandalimin e kancerit.

Dita e fundit e aktivitetit iu kushtua trajnimit mbi aplikimin e metodave kualitative në vlerësimin e programeve shëndetësore, duke sjellë një shkëmbim të vlefshëm përvojash ndërmjet ekspertëve dhe studiuesve pjesëmarrës.

Në përmbyllje të konferencës u nënvizua se, megjithëse asistenca digjitale në parandalimin e kancerit nuk përbën një “çelës magjik” dhe dallimet ndërmjet konteksteve të ndryshme mbeten të rëndësishme, kjo qasje duhet të pasqyrohet si në politikat e Bashkimit Evropian, ashtu edhe në ato kombëtare. Gjithashtu, u theksua se përfshirja e vazhdueshme e institucioneve shqiptare, si Universiteti i Mjekësisë i Tiranës, Instituti i Shëndetit Publik dhe partnerë të tjerë akademikë e kërkimorë, në rrjetet dhe projektet evropiane të kërkim-zhvillimit do të kontribuojë në rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve shëndetësore në vend.

## U prezantua projekti: “Hartografimi dhe Dokumentimi i zonave me potencial arkeologjik të Lezhës (Lissus)”



Komisioni i përhershëm i Arkeologjisë, pjesë e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave dhe me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) më 6 maj 2026 zhvilloi takimin për prezantimin shkencor të projektit “Hartografimi dhe dokumentimi i zonave me potencial arkeologjik të Lezhës (Lissus)”.

Projekti ka si qëllim përdorimin e teknologjive bashkëkohore si drone, lidar, gjeofizikë, GIS dhe WebGIS për hartografimin, dokumentimin, modelimin 3D dhe kërkim-zbulimin arkeologjik të zonës së Lisit antik, duke sjellë të dhëna të reja dhe korrigjime mbi zhvillimin protourban të qytetit ilir.

Takimin e hapi prof.dr. Neritan Ceka, kryetar i Komisionit të Arkeologjisë dhe drejtues i projektit, i cili prezantoi një vështrim të ri mbi procesin e urbanizimit të qytetit ilir Lissus, së bashku me dr. Elio Hobdari dhe dr. Ervin Kujtila.

Në vijim, prof. asoc. Dr. Edmond Hoxha, Dr. Elva Leka dhe msc. Erland Alla paraqitën rezultatet e hartografimit dhe dokumentimit të sitit arkeologjik të Lisit përmes teknologjive GIS dhe WebGIS.

Një pjesë e rëndësishme e prezantimit iu kushtua modelimit 3D të monumenteve të Lisit antik dhe mesjetar, përmes metodave lidar dhe virtual reality, nga dr. Jeton Pekmezi dhe msc. Elion Kuqali, si dhe aplikimit të metodave joinvazive të gjeofizikës për leximin e nëntokës së qytetit, nga dr. Altin Karriqi dhe prof. Përparim Alikaj.

---

Gjithashtu, një nga risitë që solli ky projekt është edhe vendosja e trashëgiminë arkeologjike në kontekstin e zhvillimit kulturor dhe turistik të zones, që u prezantua nga dr. Paulin Zefi nëpërmjet perspektivës së lidhjeve midis Lisit antik dhe komunitetit bashkëkohor.

Në përmbyllje të prezantimve dhe diskutimeve, znj. Marsela Robo, drejtoreshë e Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), i vlerësoi rezultatet e projektit me interes për nxitjen e debatit shkencor. Ajo theksoi se risitë e këtij projekti lidhen me përdorimin e teknologjive të reja, ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit arkeologjik dhe përfshirjen e gjerë të institucioneve kërkimore, bizneseve dhe shoqatave në proces.

Znj. Robo premtoi mbështetje dhe bashkëpunim nga AKKSHI për ofrimin e infrastrukturës kërkimore shkencore të arsimit të lartë publik, në shërbim të Akademisë së Shkencave, instituteve të saj dhe qendrave të tjera kërkimore. Ajo nënvizoi se kjo mbështetje do të realizohet përmes hapësirave ligjore për marrëveshjet ndër-institucionale, të cilat mundësojnë edhe financime për projekte të rëndësishme.

Në fund të këtij takimi, ajo premtoi se do të vijojë mbështetja nga AKKSHI për hartimin e projekteve madhore që do të përdorin infrastrukturën kërkimore publike, duke e konsideruar këtë si një bazë të fortë për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri.

## Dr. Shafi Gashi prezanton të dhënat e reja mbi kulturën tumulare në Kosovë



Më 5 maj 2026, Komisioni i përhershëm i Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë zhvilloi aktivitetin Lectio Magistralis me temën “Të dhëna të reja mbi kulturën tumulare në Kosovë” me autor dr. Shafi Gashin.

Veprimtaria u përshëndet nga kryetari i Komisionit, prof. dr. Neritan Ceka, i cili foli për pasuritë arkeologjike të Shqipërisë dhe Kosovës. Ndërsa e vlerësoi veprimtarinë si një kontribut të rëndësishëm në pasurimin e njohurive mbi kulturën tumulare në Kosovë dhe në Ballkan, ai theksoi nevojën për mbështetje të gërmimeve dhe studimeve të reja.

Drejtori i Institutit të Arkeologjisë, pranë ASHSH-së, akad. Adem Bunguri, hapi veprimtarinë me një prezantim vlerësues për punën dhe veprën e dr. Gashit. Fillimisht ai nënvizoi rëndësinë e pasurive të rralla arkeologjike që gjenden në varrezat tumulare dhe vendbanimet prehistorike. Ai solli një panoramë të gjerë mbi tumat si monumente të Bronzit të Hershëm, duke i lidhur me zhvillimet ekonomike, sociale dhe kulturore që solli përdorimi i bronzit në shoqëritë e hershme.

Akad. Bunguri theksoi se tumat e Bronzit të Hershëm nuk janë një fenomen i kufizuar vetëm në kulturën “kurgan”, por një dukuri universale, e pranishme në Europë, Azi dhe Amerikën Veriore. Ai i përshkroi tumat si struktura prestigji të ngritura nga aristokracia e kohës, që synonin përjetësimin e kujtimit të të parëve dhe ndryshimin e peizazhit kulturor. Ai paraqiti të dhëna konkrete për vendbanimet tumulare të Shqipërisë, ku nga

---

rreth 170 tuma të studiuara, 24 i përkasin Bronzit të Hershëm, të shpërndara në Jug dhe Veri. Ai nënvizoi se përhapja e gjerë e tumave e bën të pamundur lidhjen e tyre me një entitet të vetëm etnik, duke i vendosur si pjesë të një tradite të hershme dhe të përbotshme të epokës së bronzit. Sipas tij, tumat përfaqësojnë struktura prestigji të ngritura nga elitat e kohës, si shenjë e kujtesës së të parëve dhe e përjetësimit të tyre në peizazhin kulturor. Dr. Shafi Gashi, gjatë prezantimit të ligjëratës theksoi se në Kosovë deri më sot janë evidentuar rreth 35 nekropole tumulare me mbi 300 tuma, ndërsa vetëm në dy dekadat e fundit janë zbuluar mbi 25 nekropole të reja. Nekroplet më të mëdha janë ato të Përçevës dhe Volljakës, me mbi 120 tuma, ndërsa ndër tumat më të mëdha përmenden Gjinoci, Shpenadis dhe Jashanica. Ai shpjegoi se ndërtimi i tumave ndryshon sipas terrenit – me gurë në zonat shkëmbore dhe me dhe në zonat fushore – duke dëshmuar përshtatjen e komuniteteve të hershme. Dr. Gashi konfirmoi se kultura e Bronzit të Hershëm në Kosovë zhvillohet pa ndërprerje gjatë gjithë fazave të epokës së bronzit. Varret e hershme të tipit “pit grave” tregojnë fillimet e kësaj tradite, ndërsa varret e mëvonshme janë më të shumta, më të pasura në inventar dhe shpesh të shoqëruara me konstruksione varri.

Objektet qeramike, stolitë dhe armët e zbuluara në tumat e Bronzit të Mesëm dhe të Vonë dëshmojnë për diferencime shoqërore dhe për formimin e aristokracisë fisnore, duke e vendosur kulturën tumulare të Kosovës në një kontekst më të gjerë ballkanik dhe europian.

Në fund u diskutua rreth të dhënave të reja mbi kulturën tumulare në Kosovë, ku u theksuan veçoritë kulturore të kësaj tradite, të vërtetuara nga varret e shumta dhe inventari i pasur arkeologjik, ku dallohen objekte qeramike, stoli, armë dhe elemente të tjera që dëshmojnë diferencimet shoqërore dhe formimin e aristokracisë fisnore.

## U prezantua ligjërata e prof. dr. Tomorr Plangaricës për çështje problemore të gramatikës diskursive



Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, organizoi më 4 maj 2026 ligjëratën me temën: “Korpusi sosyrian në fillesat e institucionalizimit konjitiv të gjuhësisë së diskursit”, mbajtur nga prof. dr. Tomorr Plangarica.

Veprimtaria u hap nga prof. dr. Artur Lamaj, i cili e vlerësoi ligjëratën si një orientim të dobishëm për gjuhësinë e diskursit, duke theksuar rëndësinë e ndërtimit të dijes mbi themele të qarta dhe rolin e korpusit sosyrian. Ai nënvizoi vlerën e trashëgimisë së Ferdinand de Saussure në perspektivën e vazhdimësisë së mendimit gjuhësor.

Ligjërata u zhvillua në kuadër të ciklit “Çështje problemore të gramatikës diskursive”. Me këtë rast, prof. Plangarica paraqiti një analizë të thelluar mbi risitë e gjuhësisë së diskursit dhe rikonceptimin e trashëgimisë sosyriane në raport me strukturalizmin dhe gjuhësinë e të folurit, duke u ndalur te dorëshkrimet e tij.

Prof. dr. Plangarica theksoi se dorëshkrimet e Saussure-it, themelues i gjuhësisë moderne dhe autor i veprës së njohur *Cours de linguistique générale* (1916), të botuara pas vdekjes, patën ndikim vendimtar në zhvillimin e strukturalizmit dhe në formësimin e gjuhësisë së shekullit XX. Trashëgimia e tij mbetet thelbësore për të kuptuar zhvillimet bashkëkohore.

Ai u ndal edhe te mendimi gjuhësor shqiptar. Një vend të rëndësishëm në ligjëratën e tij zuri çështja e autenticitetit të dokumentacionit të lënë trashëgim nga Saussure-i dhe vlerësimi i atij dokumentacioni (kryesisht dorëshkrime) në korpusin sosyrian. Prof. Plangarica theksoi se në këtë korpus krijohet një hierarki disashkallëshe: vepra të publikuara – dorëshkrime – fletore studentësh – kursi i gjuhësisë së përgjithshme. Për shkak të pranisë së pakët të studimeve të botuara prej Saussure-it në gjallje të tij, marrin përparësi informacionet,

---

trajtimet dhe interpretimet e pranishme në dorëshkrimet e tij, një pasuri e vyer prej rreth pesë mijë faqesh. Duke u mbështetur në këtë trashëgimi (ende e pastudiuar sa dhe si duhet në tërësinë e saj) studiuesit e sotëm ngulmojnë për një qëndrim ndryshe ndaj shumë koncepteve të trashëguara nga tradita, si dualitetet në mendimin gjuhësor të Saussure-it: gjuhë e folur / gjuhë e shkruar, sinkroni / diakroni, gjuhësi e brendshme / gjuhësi e jashtme, gjuhë / diskurs, etj.

Dorëshkrimet mundësojnë krijimin e një ideje të qartë se Saussure-i vlerësonte po aq shqyrtimin e gjuhës sa edhe të të folurit. Ai e mendonte gjuhësinë si të ndarë në dy pjesë me vlerë të barabartë: gjuhësinë e gjuhës dhe gjuhësinë e të folurit, pa e shpërfillur këtë të fundit. Në dorëshkrime del qartë synimi për një gjuhësi dinamike dhe jo statike, ku sinkronia dhe diakronia ndihmojnë njëherazi në shqyrtimin e dukurive gjuhësore e diskursive. Për më tepër, Saussure-i kishte arritur në dallimin e konceptit “diskurs” dhe vlerave që përftohen në shqyrtime duke pasur parasysh “diskursivitetin”, “diskursiven”, “njësitë diskursive”, “gjuhën diskursive”, “ligjërimin diskursiv”, “rendin” apo “natyrën e diskursit” – të gjitha këto emërtime të pranishme në dorëshkrimet e tij, veçanërisht: “Për thelbin e dyfishtë të ligjërimin” dhe “Shënim mbi diskursin”, të përfshira tashmë në veprën e botuar më 2002: “Shkrime për gjuhësinë e përgjithshme: mbështetur në dorëshkrimet e zbuluara më 1996-ën. Po ashtu, prof. Plangarica u ndal në vlerat e jashtëzakonshme të një pjese të shpërfillur për një kohë nga gjuhëtarët – trashëgimisë sosyriane dorëshkrimore – që lidhet me studimet e Saussure-it për anagramat, metrikën e vargjeve latine, legjendat gjermanike, Vedat etj. Në këto shqyrtime, Saussure-i shfaq një qasje interesante ndaj shenjës gjuhësore, duke u prirur drejt tekstit, përtej fjalës, tekstualitetit dhe diskursivitetit. Kjo e bën atë një gjuhëtar të tekstit, ndërsa trashëgimia e tij mbetet e vlefshme për sot dhe të ardhmen e gjuhësisë së diskursit. I vendosur në raport me gjuhësinë e të folurit dhe me traditën vendase, ky rikonceptim i trashëgimisë sosyriane hap perspektiva të reja për institucionalizimin konjitiv të dijeve në gjuhësinë e diskursit.

Në mbyllje, prof. Plangarica nënvizoi rëndësinë e rileximit të veprave madhore si mënyrë për të kuptuar më mirë kapërcimet teorike dhe metodologjike në historinë e ideve gjuhësore, duke theksuar se mendimi gjuhësor shqiptar ndodhet sot në pragun e një kapërcimi të ri, ku studimet mbi shqipen po ndërthuren me qasje ndërdisiplinare dhe epistemologjike, duke e bërë këtë fushë më të hapur ndaj risive teorike.

Pas prezantimit, pjesëmarrësit, pedagogët dhe studentët, diskutuan mbi trashëgiminë sosyriane dhe ndikimin e saj në gjuhësinë moderne, si dhe mbi sfidat e modelit gjuhësor, rolin e veprave dhe perspektivat për institucionalizimin konjitiv të dijeve në gjuhësinë e diskursit.

---

**Më datën 18 maj 2026, u mbajt sesioni shkencor me tematikë “Shqipja në rrethanat e sotme digjitale”**



Në edicionin e shtatëmbëdhjetë të konferencës shkencore “Java e Albanologjisë”, organizuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës, morën pjesë edhe punonjës të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Më datën 18 maj 2026, u mbajt sesioni shkencor me tematikë “Shqipja në rrethanat e sotme digjitale”

Në këtë sesion akad. Valter Memisha mbajti kumtesën ‘Fjalori i madh i gjuhës shqipe: arritje dhe sfida’, ku së pari, vlerësoi punën e bërë për të realizuar me sukses Projektin e miratuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe u ndal te karakteri mbarëkombëtar në përmbajtje dhe në metodologjinë e hartimit, në funksionin informues dhe normativ të veprës, në karakterin sistemor dhe në risitë që mbart vepra, që kushtëzohen nga parimet e hartimit. Ai vuri theksin te puna madhore për hartimin e kësaj vepre, si dhe në ngritjen e Korpusit të posaçëm elektronik, duke vlerësuar punën në grup dhe frymën e bashkëpunimit. Prof. dr. Anila Kananaj parashtrroi kumtesën ‘Sistemi online i Fjalorit të madh të gjuhës shqipe (2026)’, ku foli për potencialin e përdorimit të platformës

---

fjalori.online/fjalori.net, duke vënë në dukje një numër risish e përparësish në krahasim me fjalorët që zakonisht printohen në letër, si dhe për drejtime ku grupi i logjistikës e i leksikografëve është duke punuar dhe mundësi të ardhshme përmirësimi të kësaj platforme dinamike me në qendër përdoruesin. Dr. Engjëllushe Karaj mbajti kumtesën ‘Vlera e leksikut dialektor në epokën digjitale: rasti i Xhuvanit’, duke u përqendruar në rolin e pazëvendësueshëm që luajnë fjalorët dialektorë në përgjithësi dhe Fjalori i Xhuvanit konkretisht, si burime që vërtetojnë, furnizojnë dhe pasurojnë shqipen në përgjithësi, por veçanërisht Fjalorin e madh të gjuhës shqipe (FMGJSH, 2026). Autorja u përqendrua në një numër rastesh konkrete nga Fjalori i Xhuvanit të integruara në Fjalorin e madh, si dhe sugjeroi një sërë lemesh e kuptimesh që mund të pasurojnë më tej Fjalorin e madh.

Më datën 19 maj 2026, u mbajt sesiioni shkencor me tematikë “Letërsia shqipe dhe konteksti”, zhvilluar në kuadër të Javës së Albanologjisë, veprimtari e përvjetshme e tij, me pjesëmarrje të studiuesve të Departamentit të Studimeve Letrare (Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë).

U trajtuan çështje të receptimit të disa veprave të letërsisë shqipe në periudhat më të rëndësishme të zhvillimit të saj me një vëmendje të veçantë në autorë që kanë lëvruar shkrimtarinë e tyre në një kohë të shtrirë në vështrim zhvillimesh letrare, çështje të censurës librore dhe të njohjes së kontekstit editorial në lidhje me veprat e letërsisë së vjetër shqipe. Konteksti letrar-mitologjik, eseistik e më gjerë u bë objekt trajtimi në kumtime të përveçme të mbajtura në këtë veprimtari shkencore.

Në këtë sesion prof. as. dr. Evalda Paci u paraqit me kumtesën me titull “Letërsia e vjetër shqipe në një optikë të zhvillimeve historike të kulturës librore”; prof. as. dr. Rovena Vata mbajti kumtesën me titull “Dritëro Agolli dhe konteksti: figura e gruas në vargjet poetike para dhe pas viteve 1990”; dr. Virion Graçi mbajti kumtesën me titull “Sizifi në kontekstin letrar-mitologjik, eseistik-filozofik dhe në historinë më të re të Kosovës”.

---

## Akademia e Shkencave e Shqipërisë pjesë e Konferencës Ndërkombëtare ICBE 2026 mbi Mjedisin e Ndërtuar dhe Gjeorreziqet



Njësia Kërkimore e Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin POLIS dhe Universitetin e Ferrarës (Itali), më 7–8 maj 2026 organizoi Konferencën e Parë Ndërkombëtare mbi Mjedisin e Ndërtuar – ICBE 2026.

Konferenca u zhvillua në ambientet e Universitetit POLIS në Tiranë dhe mbledhi studiues dhe ekspertë nga Shqipëria, Kanadaja, Zvicra, Italia, Serbia dhe Bosnja e Hercegovina, duke krijuar një forum të rëndësishëm shkencor me ndikim rajonal dhe ndërkombëtar. Programi shkencor përfshiu gjashtë prezantime keynote dhe gjashtë sesione paralele, me mbi tridhjetë prezantime nga studiues të rinj dhe të konsoliduar.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë ishte e përfaqësuar në dy nivele. Në nivel institucional, përmes fjalës përshëndetëse në ceremoninë e hapjes nga akad. asoc. Rrapo Ormeni, i cili përcolli mbështetjen e Akademisë për nisma të tilla shkencore ndërkombëtare dhe theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional. Në nivel shkencor, përmes prezantimit keynote të Prof. Dr. Markel Baballëkut, studiues i Njesisë së Gjeoshkencave dhe Gjeoinxhinierive pranë Akademisë dhe profesor i asociuar në Departamentin e Inxhinierisë Civile të Universitetit Politeknik të Shqipërisë, me temën “Evaluating the Seismic Risk: The Case of Tirana City”.

---

Ky prezantim trajtoi metodologjinë e vlerësimit të rrezikut sizmik urban në qytetin e Tiranës, duke ofruar një kontribut të rëndësishëm strategjik për planifikimin territorial dhe mbrojtjen civile. Ai u vlerësua si një nga kontributet kryesore aplikative me fokus kombëtar ndër keynote speaker-ët ndërkombëtarë.



Programi shkencor i ICBE 2026 u zhvillua në sesione paralele sipas tematikave. Nga perspektiva e Njesisë së Gjeoshkencave u evidentuan sesione me rëndësi të veçantë, përfshirë sesionin “Next-Generation Pioneers of the Built Environment”, i cili trajtoi qasje të integruara për menaxhimin e rrezikut nga përmytjet në Shqipëri, si dhe sesionin “Cultural Heritage”, ku u diskutua vlerësimi i performancës sizmike të ndërtesave historike, përfshirë raste studimore nga Gjirokastra. Një pjesë e rëndësishme e prezantimeve keynote u fokusua gjithashtu në gjeoteknikë, sizmologji dhe monitorim strukturor, duke e vendosur çështjen e gjeorreziqeve në qendër të konferencës.

Pjesëmarrja e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë në ICBE 2026 dëshmoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve publike shkencore dhe universiteteve kërkimore, si Universiteti POLIS, duke forcuar sinergjinë shkencore dhe ndikimin në politikat publike. Konferenca konfirmoi gjithashtu rolin në rritje të Njesisë së Gjeoshkencave si aktor i rëndësishëm në kërkimin shkencor kombëtar dhe ndërkombëtar në fushën e gjeorreziqeve, rezistencës sizmike dhe planifikimit të qëndrueshëm urban.

## U zhvillua workshop-i EduMat 2026 me temën “Edukimi Matematik në Epokën e STEM dhe Teknologjisë”



Workshop-i u mbajt sot, më 23 maj 2026, nën organizimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Institutit Kombëtar të Matematikës pranë saj, në bashkëpunim me Departamentin e Matematikës të Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.

Kjo veprimtari shkencore synon promovimin e mësimdhënies së matematikës nëpërmjet qasjes STEM, duke e vendosur atë në një kontekst të integruar me shkencën, teknologjinë dhe inxhinierinë, si dhe prezantimin e metodave inovative, mjeteve digjitale dhe praktikave ndërdisiplinore që nxisin mendimin kritik dhe zgjidhjen e problemeve reale. Workshopi u hap nga prof. dr. Fatmir Hoxha, Kryetari i Komisionit Matematikë-Informatikë dhe anëtar i bordit të Institutit Kombëtar të Matematikës.

Në fjalën përshëndetëse, akad. Neki Frashëri, Kryetar i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike vlerësoi rëndësinë e workshop-it për edukimin matematik dhe rolin që kjo fushë ka në zhvillimin e shoqërisë. Ai theksoi nevojën e ngutshme për hartimin e rekomandimeve praktike që do të përmirësojnë mësimdhënien e matematikës në nivele të ndryshme arsimore, duke u ndalur, gjithashtu, te sfidat dhe rreziqet që sjell inteligjenca artificiale në edukim. Sipas tij, përveç mundësive të mëdha që ofron, inteligjenca artificiale kërkon reflektim të thellë mbi etikën, besueshmërinë e të dhënave dhe rolin e mësuesit si udhëheqës i procesit mësimor.

Punimet e workshop-it u përshëndetën edhe nga prof. asoc. Rudina Osmanaj, zv. dekane e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Seanca e parë plenare, e drejtuar nga prof. asoc. Eriola Sila, nisi me ligjëratën e prof. dr. Xhevdet Thaqit (Universiteti "Kadri Zeka", Kosovë), i cili trajtoi arsimin matematik të bazuar në kompetenca dhe vlerësimet PISA, duke sjellë një perspektivë të qartë mbi sfidat dhe mundësitë e sistemit arsimor. Ai nënvizoi se edukimi matematik është një shtyllë e fortë e platformës EduMat, e cila synon të forcojë kompetencat profesionale të mësuesve dhe të nxisë bashkëpunimin ndërinstitucional.



Në vijim, referues të tjerë si prof. asoc. Suela Kacerja (South-Eastern Norway University, Norvegji), prof. asoc. Lekë Pepkolaj, prof. asoc. Elisabeta Peti, prof. asoc. Frederik Dara, dr. Ilir Palla, msc. Vasil Lino, si dhe dr. (c) Denisa Xhuti, prezantuan qasje bashkëkohore mbi modelimin matematik në projekte energjetike, përdorimin e inteligjencës artificiale dhe teknologjisë në klasë, përditësimin e kurrikulës së matematikës dhe praktika të mira nga mësues të shkollave të mesme të Tiranës.

Në sesionin e pasdites, mësues të shkollave të mesme dhe specialistë të përdorimit të mjeteve digjitale prezantuan praktika të aplikueshme në klasë, si modeli matematikor i qyteteve të qëndrueshme, përdorimi i matematikës në sistemin bankar, gjeometria në projektin urban dhe projektet STEAM.

Në mbyllje të punimeve, u diskutua mbi përvetësimin e metodave inovative dhe mjeteve digjitale në arsimim, rolin e inteligjencës artificiale, si dhe aplikimet e matematikës në

---

jetën reale. Diskutimet vunë theksin në krijimin e një rrjeti bashkëpunimi ndërmjet pedagogëve, mësuesve dhe studiuesve, duke forcuar lidhjen ndërmjet institucioneve arsimore dhe komunitetit akademik, me synimin për të kontribuar në përmirësimin e cilësisë së edukimit matematik në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në STEM.

---

# Promovime

## U mbajt konferenca shkencore për promovimin e kolanës së botimeve shkencore të akademikut Rexhep Meidani



Më 25 maj 2026, u mbajt konferenca shkencore ndërkombëtare me temë, “Nga gigabota te grimcat elementare, gjithçka lëviz e vetorganizohet: kjo është fizika”, me rastin e promovimit të kolanës së veprës shkencore të akademikut Rexhep Meidani, kushtuar kategorive themelore të fizikës: hapësirës, kohës, materies dhe lëvizjes.

Aktiviteti u organizua nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës dhe Institutin Kombëtar të Fizikës, me synimin për të vlerësuar rëndësinë e veçantë të këtyre botimeve në fushën e fizikës dhe të mendimit shkencor bashkëkohor, ku reflektohet përvoja shumëvjeçare akademike, kërkimore dhe intelektuale e autorit.

Akad. Mimoza Hafizi, drejtuese e Institutit Kombëtar të Fizikës dhe moderatore e

veprimtarisë, në fjalën e mirëseardhjes theksoi se katër botimet e akad. Meidanit ishin arsyeja kryesore e organizimit të kësaj konference kushtuar fizikës. Ajo nënvizoi se Meidani mbetet thellësisht i lidhur me këtë disiplinë, të cilës i ka kushtuar gjithë jetën akademike dhe që e ka transmetuar me përkushtim të studentët dhe bashkëpunëtorët ndër vite.

Sipas saj, konferenca synoi të ndërthurte promovimin e botimeve me reflektimin mbi zhvillimet dhe sfidat aktuale të kërkimit shkencor në fizikë.

Në hapje të konferencës, Kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Skënder Gjinushi, përshëndeti pjesëmarrësit dhe organizatorët, duke vlerësuar promovimin e figurës akademike të Rexhep Meidanit si pjesë përbërëse të misionit institucional të Akademisë. Ai theksoi se vlerësimi i jetës dhe veprimtarisë së personaliteteve të shquara të shkencës nuk shërben vetëm për të evidentuar kontributet e tyre, por përbën një detyrim institucional dhe moral.



Akad. Gjinushi vuri në dukje rigorozitetin shkencor dhe korrektësinë e akad. Meidanit, duke e cilësuar atë si një personalitet që ka ndikuar jo vetëm në zhvillimin e fizikës, por edhe në jetën politike të vendit. Ai solli në vëmendje rolin e tij si President i Republikës gjatë krizës së vitit 1998, duke vlerësuar aftësinë e tij për të mbështetur zgjidhje institucionale dhe kushtetuese në një moment kritik për vendin.

Kryetari i Akademisë shprehu bindjen se botimet e reja të akad. Meidanit do të shërbejnë për të nxitur interesin e të rinjve për shkencat e natyrës dhe për të frenuar largimin e trurit nga Shqipëria. Ai u ndal veçanërisht te sfidat me të cilat përballen sot shkencat e natyrës, duke evidentuar kontrastin midis zhvillimit të vrullshëm të teknologjive moderne, përfshirë inteligjencën artificiale dhe eksplorimin hapësinor, dhe rënies së interesit të të rinjve për t'iu përkushtuar shkencave fundamentale.

Sipas tij, mjedisi akademik shqiptar ka detyrimin të promovojë modele të spikatura edhe në fushat natyrore dhe inxhinierike, krahas traditës së konsoliduar në shkencat albanologjike.



Veprimtaria e akad. Meidanit pasqyrohet në një numër të gjerë botimesh shkencore, filozofike dhe publicistike, ndër të cilat një vend të veçantë zënë katër titujt e promovuar në këtë konferencë.

Seanca e parë vijoi me fjalën e akad. Floran Vila, i cili e vlerësoi akad. Meidanin si personalitet me dimensione të mëdha akademike dhe kontribute shtetërore. Më pas, akad. Rexhep Meidani prezantoi një përmbledhje të punimeve shkencore me temën “Universi, materia, hapësirë-koha dhe lëvizja fizike”, ku paraqiti një panoramë të

---

zhvillimeve bashkëkohore në fizikën teorike. Ai vuri theksin te disa nga temat themelore të fizikës që trajtohen në kolanën e librave të tij, si përbërja dhe evolucioni i universit, kategoria e materies, si dhe konceptet e hapësirës, kohës dhe lëvizjes. Ai e paraqiti fizikën si një proces vetorganizues, ku fenomenet e universit lidhen në mënyrë të brendshme dhe të vazhdueshme, duke e vendosur kërkimin shqiptar në dialog me zhvillimet ndërkombëtare dhe duke nxjerrë në pah dimensionin konceptual të fizikës përtej aplikimeve teknike.

Seanca e dytë vijoi me referime nga studiuesit prof. Claude Charlot nga Ecole Polytechnique, Francë, prof. Kimet Jusufi nga Universiteti i Tetovës, prof. dr. Margarita Ifti nga Universiteti i Tiranës dhe akad. Mimoza Hafizi. Ata trajtuan çështje të rëndësishme të fizikës moderne, duke u ndalur në zhvillimet e kërkimit mbi bozonin Higgs, problematikat e singulariteteve dhe energjisë së errët, lidhjet mes lëvizjes termike dhe sistemeve komplekse, si dhe panoramën e kërkimit shkencor në Shqipëri nga gigabota te grimcat elementare.

Në kuadër të konferencës u prezantuan gjithashtu edhe referime nga studentë doktore, të cilët ndanë rezultatet e punës së tyre kërkimore në fusha të ndryshme të fizikës.

Aktiviteti shërbeu si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e ideve, promovimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve akademike shqiptare dhe atyre ndërkombëtare.

---

**Akademiku Matteo Mandalà boton në Itali monografinë “Nel nome di Luigi Pirandello e gli Arbëreshë”**




Sapo ka dalë nga shtypi në Itali vepra “Nel nome di Luigi Pirandello e gli Arbëreshë” e akademikut Matteo Mandalà, anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Vepra është botuar në serinë “Albanistika” (nr. 17) të Fondacionit Universitar Francesco Solano.

Monografia në thelb është një studim sistematik e i plotë, që përmbledh tri studime kritike dhe një dokumentacion të pasur arkivor të pabotuar më parë - letërkëmbime, fotografi dhe materiale të tjera - mbi marrëdhëniet miqësore, kulturore dhe artistike që shkrimtari i madh italian Luigi Pirandello pati gjatë rinisë së tij, në vitet e formimit intelektual dhe gjatë qëndrimit në Palermo, me botën arbëreshe.

Vëmendje e veçantë i kushtohet lidhjes së ngushtë të Pirandellos me Giuseppe Schirò-in, me të cilin ndante një sfond të përbashkët formativ e letrar. Studimi sjell në dritë shkëmbimet e dendura të ideve dhe materialeve ndërmjet tyre, si edhe faktin domethënës se, gjatë qëndrimit të tij në Gjermani, Pirandello përktheu në gjermanisht këngën e parë

të idilit “Mili e Hajdhia” të mikut të tij arbëresh.

Falë mjeshtërisë së njohur hermeneutike të akademikut Mandalà, monografia zbulon me argumente bindëse dhe dokumentacion të plotë ndikimin vendimtar që patën dy intelektualë të tjerë arbëreshë, Gavril Dara i Riu dhe Nicola Barbato, në intrigën e romanit të njohur të Pirandellos “I vecchi e i giovani”.



Rëndësia shkencore dhe filologjike e kësaj vepre theksohet edhe në parathënien e firmosur nga Aldo Maria Morace, president i Edicionit Kombëtar të veprës Omnia të Pirandellos, i cili e vlerëson monografinë si një kontribut të rëndësishëm në studimet pirandelliane dhe në ndriçimin e marrëdhënieve historike e kulturore mes traditës italiane dhe asaj arbëreshe.

## Akademia e Shkencave e Shqipërisë promovoi trilogjinë muzikologjike të autores Kristina Palokaj-Perkola



Tre libra të autores Kristina Palokaj-Perkola, që trajtojnë historinë dhe zhvillimin e muzikës në Kosovë, u promovuan sot në ambientet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, me organizimin e Komisionit të Përhershëm të Arteve. Aktiviteti u moderua nga dr. Denis Bizhga, ndërsa në panel morën pjesë zv. kryetari i Akademisë së Shkencave akad. Vasil Tole, prof. dr. Rafet Rudi dhe prof. asoc. dr. Mikaela Minga.

Zv. kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Vasil Tole e vlerësoi trilogjinë e përbërë nga librat “Dy jetë për muzikë”, “Skena muzikore e Prishtinës” dhe “The Outlines of Social History of Music in Kosovo” si një korpus studimesh që ndriçon historinë e muzikës së kultivuar në Kosovë. Ai theksoi se kjo trilogji pasqyron zhvillimet artistike, shoqërore dhe historike të muzikës shqiptare në Kosovë. Më tej, akad. Tole, njëkohësisht kryetar i Komisionit të Arteve, e vlerësoi autoren si një emër të rëndësishëm në muzikologjinë shqiptare, duke e vendosur kërkimin e saj në vazhden e punimeve të studiuesve të njohur si Lorenc Antoni, Engjëll Berisha, Zeqirja Ballata, Akil Koci, Rafet Rudi, Rreze Kryeziu e të tjerë. Ai nënvizoi seriozitetin shkencor dhe qasjen identitare të autores, që i jep një dimension të ri promovimit të kulturës muzikore shqiptare në arenën ndërkombëtare. Ky aktivitet, i organizuar nga Komisioni i Përhershëm i Artit pranë Akademisë së Shkencave, është dëshmi e bashkëpunimit të frytshëm ndërmjet

institucioneve akademike të Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe e përpjekjes për të ndërtuar një hapësirë të përbashkët kulturore e shkencore në fushën e muzikës.

Trilogjia u vlerësua edhe nga kompozitori prof. dr. Rafet Rudi, i cili spikati kontributin e autores në dokumentimin e jetës muzikore shqiptare. Ai theksoi se dokumentacioni i sistemuar për jetën muzikore të dikurshme në Kosovë mungon, pasi shumë materiale janë humbur në periudha të vështira historike. Megjithatë, një gjeneratë e re studiuesish po përpiqet të rikonstruktojë gjurmët e zbehura të asaj kohe.

Në këtë kuadër, prof. dr. Rudi përmendi se ka vënë në dispozicion të studiueseve Kristina Palokaj-Perkola dhe Rreze Kryeziu materiale arkivore të ruajtura në bibliotekën e tij: programe koncertesh, broshura festivalesh, postera, shkrime gazetash e fotografi, për t'i ndihmuar në studimet e tyre. Ai vlerësoi punimin e Kristina Palokaj-Perkolës për Festivalin "Skena Muzikore e Prishtinës" (1974-1988) si një rikonstruksion të plotë dhe të suksesshëm të një periudhe të rëndësishme të kulturës muzikore kosovare.

Prof. dr. Rudi e cilësoi veprën si një kontribut të rëndësishëm për kulturën shqiptare, që ndihmon në ruajtjen e kujtesës muzikore dhe në ndriçimin e një periudhe të pak dokumentuar të historisë sonë artistike.



Prof. asoc. dr. Mikaela Minga prezantoi librin "The Outlines of a Social History of Music in Kosova", duke e cilësuar si një studim me vlera të qëndrueshme për muzikologjinë

---

shqiptare dhe një hap të rëndësishëm drejt ndërkombëtarizimit të kulturës muzikore kosovare.

Dr. Denis Bizhga analizoi librat “Skena Muzikore e Prishtinës” dhe “Dy jetë për muzikën”, duke i vlerësuar si modele të rikonstruksionit historik dhe si kontribute të shumëfishta: shkencore, dokumentare dhe kulturore. Gjithashtu, ai vlerësoi ndërthurjen me mjeshtëri të analizës muzikologjike, studimit historik dhe reflektimit estetik. Dr. Bizhga e cilësoi trilogjinë e Kristina Palokaj-Perkolës si një kontribut të shumëfishtë dhe dëshmi të fuqisë së artit për të kapërcyer kohën dhe për të bashkuar hapësirat shqiptare në një kujtesë të përbashkët muzikore.

Pas diskutimeve rreth librave, autorja Kristina Palokaj-Perkola ndau përvojën kërkimore dhe motivimin që e shtyu të realizojë trilogjinë muzikologjike, duke e cilësuar si një përpjekje për të ruajtur kujtesën kulturore dhe për të ndërtuar një bazë të qëndrueshme për studime të ardhshme.

Kristina Palokaj-Perkola (1986) është muzikologe e diplomuar në Universitetin e Prishtinës dhe doktoruar në Universitetin e Zagrebit, ku ka marrë titullin Doktor i filozofisë në muzikologji. Ajo ka përvojë të gjatë në arsimin e mesëm dhe universitar, ka ligjruar lëndë nga fusha e muzikologjisë, etnomuzikologjisë dhe estetikës së artit, si dhe është autore e disa librave dhe artikujve shkencorë të botuar në revista kombëtare e ndërkombëtare. Aktualisht, ajo është profesoreshë në shkollën e profesoreshë në shkollën e mesme të lartë “Prek Jakova” në Prishtinë dhe ligjëruese në Kolegjin UBT.

---

## Promovohet libri i akademikut Vasil S. Tole për Laver Bariun dhe trashëgiminë e sazeve



Në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë u zhvillua sot ceremonia e promovimit të librit “Laver Bariu, ustai i fundit” të akademikut Vasil S. Tole, botim i shtëpisë botuese “Onufri”.

Aktiviteti, i konceptuar si një takim miqsh me figurën e Usta Laverit dhe trashëgiminë e tij muzikore, mbledhi personalitete të botës akademike, përfaqësues të institucioneve kulturore dhe dashamirës të muzikës popullore.

Veprimtaria u moderua nga z. Andreas Dushi, drejtor i Qendrës së Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike, i cili vlerësoi përmbajtjen e veprës dhe metodologjinë e saj të kujdesshme.

Në fjalën e tij përshëndetëse, akad. Gëzim Hoxha, kryetar i Seksionit të Shkencave

---

Shoqërore e Albanologjike në Akademinë e Shkencave, vlerësoi botimin e akademikut Vasil S. Tole si një ndërmarrje serioze shkencore dhe një akt të rëndësishëm kujtесе kulturore.

Ai theksoi se libri “Laver Bariu – ustai i fundit” nuk është thjesht një monografi, por një rrëfim i shumëzëshëm ku ndërthuren historia, përvoja artistike dhe dëshmia njerëzore, duke sjellë një portret të gjallë të mjeshtrit të sazeve të Përmetit.

Akad. Hoxha vuri në dukje se vepra e Usta Laverit është pjesë e një tradite të gjallë, të ripërmasuar nga individualiteti i tij krijues, e cila ka marrë vlerësim ndërkombëtar nga UNESCO si “Kryevepër e trashëgimisë gojore të njerëzimit”. Ai e cilësoi librin si një kontribut të vyer për studimet mbi iso-polifoninë shqiptare dhe një model metodologjik që ndërton portretin e artistit përmes kujtimeve, analizave dhe dëshmive të bashkëkohësve.



Në përfundim, akad. Hoxha theksoi se muzika e Laver Bariut nuk ka një fund, por mbetet pjesë e trashëgimisë së gjallë dhe identitetit kulturor kolektiv. Ai vlerësoi autorin Vasil S. Tole për kontributin e tij të jashtëzakonshëm në dokumentimin dhe promovimin e muzikës tradicionale shqiptare, duke e cilësuar këtë botim si një akt studimi, kujtесе dhe përgjegjësie ndaj identitetit kulturor të vendit.

Botuesi Bujar Hudhri solli perspektivën e shtëpisë botuese Onufri lidhur me botimin e veprës dhe theksoi mënyrën e veçantë se si autori ka studiuar personalitetin artistik të Laver Bariut, duke e vendosur në pedestal si figurë emblemë të kulturës shqiptare.

---

Një përshëndetje e veçantë erdhi edhe nga kryetarja e Bashkisë së Përmetit, znj. Alma Hoxha, e cila e cilësoi Laver Bariun si njeriun që e ktheu klarinetën në zë të shpirtit shqiptar, duke e bërë figurë emblematike të qytetit dhe të traditës muzikore.

Programi u pasurua me interpretimin e “Kaba me bakllama” nga Fatmir Lela, si dhe me përshëndetjet muzikore të sazeve të Përmetit.

Në vijim të këtij takimi, prof. dr. Artan Shkreli solli reflektime mbi dimensionin kulturor e muzikor të veprës, duke vlerësuar kontributin e autorit në trashëgiminë kulturore.

Prof. asoc. Mikaela Minga e analizoi librin edhe nga perspektiva e kompozitorit, duke e cilësuar si themel të domosdoshëm për etnomuzikologjinë dhe për vendosjen e Laver Bariut në qendër të muzikës me saze.

Autori akad. Vasil S. Tole ndau me të pranishmit rrugëtimin në hartimin e librit, duke theksuar se ky botim është njëherazi libri i sazeve dhe i muzikës popullore qytetare të Shqipërisë së Jugut. Ai shpjegoi se teksti prej 450 faqesh përfshin fotografi, transkriptimet, bibliografi specifike dhe QR Code me ilustrime të trashëgimisë muzikore të Usta Laverit. Në fund, autori falënderoi botuesin, redaktorët dhe organizatorët e veprimtarisë.

Ceremonia u mbyll me falënderimet e familjarëve të Usta Laverit, të cilët shprehën mirënjohjen për nderimin e figurës së tij dhe përkushtimin e autorit në ruajtjen e kujtesës kulturore.

---

**Të tjera**

## Kujtojmë në ditën e lindjes Heroin Kombëtar Gjergj Kastriot Skënderbeun



Më 6 maj 1405 lindi Gjergj Kastrioti Skënderbeu, një nga figurat më të përfaqësueset e historisë shqiptare dhe një nga udhëheqësit politikë e ushtarakë më të spikatur të Europës së shekullit XV.

Veprimtaria e tij nuk ishte thjesht rezistencë ushtarake, por një "projekt" shumëdimensional pushteti, organizimi dhe diplomacie, që i vendosi trojet arbërore në hartën politike të kohës.

Konsolidimi i autoritetit të tij nisi me rimarrjen e Krujës në nëntor 1443 dhe u institucionalizua me Kuvendin e Lezhës më 2 mars 1444, ku ai themeloi Besëlidhjen e Lezhës si strukturën e parë të përbashkët politike dhe ushtarake arbërore. Në udhëheqjen e Skënderbeut, forcat shqiptare shënuan fitore vendimtare në Torvioll, Domosdovë, Pollog dhe Vajkal, duke demonstruar një art të avancuar të komandimit dhe shfrytëzimit strategjik të terrenit.

Paralelisht, Skënderbeu zhvilloi një veprimtari të qëndrueshme diplomatike me Selinë e Shenjtë (Vatikanin), Mbretërinë e Napolit dhe qytet-shtetet italiane, duke e pozicionuar qëndresën arbërore si pjesë të ekuilibrave europianë. Në historiografinë bashkëkohore, ai vlerësohet si faktor themelor në formësimin e vetëdijes politike dhe shtetërore të

---

shqiptarëve, ndërsa trashëgimia e tij mbetet boshti qendror i vazhdimësisë historike dhe identitare shqiptare në kontekstin evropian.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu u nda nga jeta më 17 janar 1468.

---

## Akademia e Shkencave uron 90-vjetorin e lindjes së akademikun Muzafer Korkuti



Kryesia e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë shpreh urimet më të përzemërta në 90-vjetorin e lindjes së akademikut Muzafer Korkuti, një prej personaliteteve më të shquara të shkencës shqiptare, studiues i palodhur dhe figurë qendrore e arkeologjisë prehistorike shqiptare.

Jeta dhe veprimtaria e tij janë të lidhura ngushtë me historinë e kërkimeve arkeologjike në Shqipëri dhe me ndërtimin e traditës moderne të studimeve mbi prehistorinë, neolitin, eneolitin dhe qytetërimin ilir. Pas diplomimit në degën e Historisë në Universitetin e Tiranës (1962), ai iu përkushtua për dekada kërkimit shkencor dhe dokumentimit të trashëgimisë së lashtë shqiptare.

---

Akademik Korkuti ka drejtuar gërmime dhe ekspedita arkeologjike në qendra të rëndësishme si Tren, Dunavec, Vashtëmi, Burim, Cakran, Patos, Bënjë, Katundas, Kolsh, Çetush, Gradec dhe Konispol, duke sjellë dëshmi të rëndësishme për zhvillimin kulturor dhe historik të rajonit në periudhat më të hershme të njerëzimit. Punimet e tij kanë kontribuar jo vetëm në pasurimin e arkeologjisë shqiptare, por edhe në afirmimin ndërkombëtar të saj.

Përveç kontributit në terren, akademik Muzafer Korkuti ka mbajtur role të rëndësishme drejtuese në jetën shkencore dhe akademike të vendit. Ai ka qenë kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, drejtor i Institutit të Arkeologjisë në dy periudha të rëndësishme, kryeredaktor i revistës shkencore "Iliria". Veprimtaria e tij institucionale është karakterizuar nga përkushtimi për zhvillimin e shkencës, mbështetjen e brezave të rinj të studiuesve dhe promovimin e trashëgimisë kulturore shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Kontributet e tij janë vlerësuar edhe jashtë vendit: anëtar i Komitetit të Përhershëm të Shkencave Pre/Protohistorike Botërore, anëtar korrespondent i Institutit Gjerman të Arkeologjisë, si dhe i dekoruar me urdhrin "Mjeshtër i Madh".

Veprat e tij, ndër të cilat "Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri", "Arti shkëmbor në Shqipëri" (botuar edhe në Universitetin e Heidelbergut, duke afirmuar ndërkombëtarisht veprën e tij), "Harta Arkeologjike e Shqipërisë" dhe "Archaeological Studies on the Prehistory of Albania, mbeten referenca themelore për studiuesit e arkeologjisë dhe historisë së lashtë".

Një kontribut i veçantë është edhe studimi i piktogrameve prehistorike, ku zbulimet shqiptare janë përfshirë në rrjetin e studimeve evropiane mbi artin shkëmbor, krahas Italisë, Francës dhe Malit të Zi. Akad. Myzafer Korkuti ka udhëhequr gjithashtu restaurimin e pikturës së Lepenicës nga një grup shqiptaro-spanjoll, duke ruajtur një monument me vlerë evropiane.

Në këtë përvjetor jubilar, Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpreh vlerësimin më të lartë për figurën dhe veprën e akademikut Muzafer Korkuti, duke e konsideruar atë një nga personalitetet më përfaqësuese të shkencës shqiptare bashkëkohore.

Me punën, përkushtimin dhe autoritetin e tij shkencor, ai ka lënë një gjurmë të pashlyeshme në studimet albanologjike dhe në ruajtjen e kujtesës historike të kombit shqiptar.

Gëzuar 90-vjetorin!

## Akademia e Shkencave nderon në 90-vjetorin e lindjes anëtarin dhe ish-kryetarin e saj, akademik Myzafer Korkuti



Sot, më 18 maj 2026, në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u zhvillua aktiviteti jubilar kushtuar 90-vjetorit të lindjes së akademikut Myzafer Korkuti. Veprimtaria u organizua nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike, në bashkëpunim me Institutin e Arkeologjisë dhe Komisionin e Përhershëm të Arkeologjisë, me pjesëmarrjen e akademikëve, kolegëve dhe miqve të akad. Korkutit.

Kryetari i SSHSHA, akad. Gëzim Hoxha, vuri në dukje se veprimtaria shkencore për ditëlindjen jubilarë të arkeologut të shquar akad. Myzafer Korkuti synon të sjellë në vëmendje kontributin e tij në studimet mbi etnogjenezën e ilirëve, rolin e tij në drejtimin e arkeologjisë shqiptare, si dhe ndikimin e tij në arkeologjinë e Kosovës.

Veprimtarinë e përshëndeti Kryetari i Akademisë së Shkencave, akad. Skënder Gjinushi. Fillimisht ai i shprehu akad. Korkutit urimet më të përzemërta në këtë përvjetor, duke i shoqëruar me mirënjohjen më të thellë institucionale për një jetë të tërë të përkushtuar ndaj shkencës, dijes dhe identitetit kulturor të historisë e origjinës së vendit dhe popullit tonë. “Edhe një herë, mirënjohjen tonë më të sinqertë për gjithçka që keni bërë për

shkencën shqiptare”, u shpreh ai.

Më tej, Kryetari i Akademisë vlerësoi jetën dhe veprën e profesor Korkutit si një shembull të përkushtimit dhe vizionit shkencor, duke theksuar rolin e tij në themelimin e arkeologjisë prehistorike shqiptare, në drejtimin e ekspeditave të rëndësishme dhe në formimin e brezave të rinj. Ai nënvizoi se “emri dhe vepra e akad. Korkutit do të mbeten përgjithmonë pjesë e historisë së Akademisë dhe të shkencës shqiptare”.



Në fund të fjalës së tij, akad. Gjinushi vlerësoi edhe një dimension të veçantë të personalitetit të tij, siç është ai i pedagogut dhe formuesit të brezave. Për dekada me radhë, ai ka qenë një udhërrëfyes i sigurt për studentët dhe studiuesit e rinj, duke përcjellë

---

jo vetëm dije, por edhe metodë, etikë shkencore dhe pasion për kërkimin. Po aq i rëndësishëm është edhe roli i tij si drejtues. Si drejtor i Institutit të Arkeologjisë në disa periudha kyçe, si dhe si Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ai ka kontribuar në konsolidimin dhe zhvillimin e institucioneve shkencore, duke forcuar rolin e tyre në jetën akademike dhe shoqërore të vendit.

Akad. Gjinushi u shpreh se vlerësimet dhe dekoratat e larta shtetërore e akademike që ai kishte marrë ndër vite ishin dëshmi e një vlerësimi të merituar për kontributin e tij të jashtëzakonshëm.

“Veçojmë në mes këtyre nderimin nga Presidenti i Republikës me dekoratën e lartë “Nderi i Kombit” me motivacionin: “Për drejtimin profesional dhe vizionar të Institutit të Arkeologjisë e të Akademisë së Shkencave; në vlerësim të kontributit të vyer shumëvjeçar për përparimin e shkencës së arkeologjisë dhe qasjen e saj te publiku i gjerë, si dhe për angazhimin e përhershëm në ndërtimin e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit me studiuesit ndërkombëtar në fushën e kërkimeve dhe studimeve arkeologjike”, tha akad. Gjinushi.

Kryetari i Institutit të Arkeologjisë, akad. Adem Bunguri, theksoi se akad. Korkuti është një nga figurat qendrore të brezit të dytë të arkeologjisë institucionale, i cili me gërmimet dhe studimet e tij në qendra si Tren, Dunavec, Vashtëmi, Cakran e Konispol ka sjellë dëshmi të rëndësishme për prehistorinë dhe qytetërimin ilir. Veprat e tij, ndër të cilat “Qytetërimi neolitik dhe eneolitik në Shqipëri” dhe “Arti shkëmbor në Shqipëri”, mbeten referenca themelore për studiuesit.


Në fund të fjalës së tij, akad. Bunguri vlerësoi veçanërisht disiplinën e lartë shkencore të akad. Korkutit, përdorimin e metodave moderne si datimet radiokarbonike, klasifikimin e qeramikës në terren dhe kujdesin për formimin e arkeologëve të rinj.

Veprën e akad. Korkutit e vlerësuan edhe prof. dr. Neritan Ceka, kryetar i Komisionit të Arkeologjisë; prof. dr. Ilir Gjipali; prof. dr. Kemajl Luci; dhe dr. Rovena Kurti, të cilët nënvizuan veprimtarinë e tij kërkimore të lidhur ngushtë me zbulimin, dokumentimin dhe interpretimin e kulturave të hershme në territorin e Shqipërisë, duke filluar nga epokat e neolitit dhe eneolitit, e deri te formësimi i etnosit dhe kulturës ilire.

Një vend të veçantë në ligjëratat e tyre zunë edhe ekspeditat dhe gërmimet e drejtuara prej tij në qendra të rëndësishme si Maliqi, Treni, Dunavec, Vashtëmi apo Konispoli, të cilat kanë shënuar etapa të rëndësishme në njohjen shkencore të prehistorisë sonë.

Në mbyllje të veprimtarisë, kolegë dhe miq i shprehën urime të e përzemërta dhe vlerësimin e mirënjohjen më të sinqertë akademik Myzafer Korkutit për gjithçka që ka bërë për shkencën shqiptare.


## “Studimet mbi ADN e hershme rikonfirmojnë autoktoninë e shqiptarëve”



-Rezultate të dala nga një studim i realizuar nga një ekip ndërkombëtar studiuesish, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë-

Një studim i ri i botuar në revistën ndërkombëtare “Nature Human Behaviour” ka sjellë dëshmitë më të qarta deri më sot mbi origjinën e shqiptarëve, duke konfirmuar vazhdimësinë e tyre gjenetike që nga Epoka e Bronzit deri në ditët e sotme. Ky punim u realizua nga një ekip ndërkombëtar studiuesish, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe përfshiu analizën e mbi 6,000 gjnomeve të lashta nga Ballkani dhe Eurazia Perëndimore, si dhe 74 gjnome të reja nga shqiptarët modernë. Në këtë studim janë përdorur të dhëna të përfuara nga analizat e gjenetikës molekulare të mbështetura në ADN-në e lashtë (aADN), si dhe teknika të sofistikuar statistikore, përfshirë metodën ancient identity-by-descent (ancIBD), e cila lejon gjurmimin e lidhjeve të thella gjenealogjike midis popullatave moderne dhe individëve të lashtë. Rezultatet tregojnë se, ndryshe nga pjesa më e madhe e Europës Juglindore e cila u riformësua nga migrime masive, paraardhësit e shqiptarëve mbetën krahasimisht të paprekur, duke ruajtur lidhje të forta me popullsitë autoktone të Ballkanit. Një zbulim i veçantë lidhet me një individ të shekujve IX-X nga Shtika në jug të Shqipërisë, i cili rezulton gjenetikiisht më i afërt me shqiptarët e sotëm sesa me çdo popullsi tjetër të njohur. Ky fakt përbën dëshminë e parë të drejtpërdrejtë gjenetike për

një bashkësi të hershme shqipfolëse, shumë kohë përpara se gjuha shqipe të dokumentohej me shkrim.



Studimi konfirmon se shqiptarët rrjedhin kryesisht nga popullsia autoktone ballkanike, duke ruajtur identitetin e tyre përmes shekujve, ndërkohë që dallimet e holla gjenetike midis gegëve dhe toskëve pasqyrojnë zhvillime historike rajonale.

Akademia e Shkencave e Shqipërisë po vazhdon intensivisht punën për studime më të thelluara mbi gjenetikën e popullatës shqiptare, duke synuar të sjellë prova edhe më të plota mbi autoktoninë e padiskutueshme të shqiptarëve dhe rolin e tyre unik në historinë e Europës.

## Shkenca në dialog me politikëbërjen për të formësuar të ardhmen strategjike të Europës



“Drejt Lirisë së Pestë Europiane dhe Konkurrencës Globale: Zërat e Shkencës”, një aktivitet i rëndësishëm shkencor dhe politik mbi të ardhmen e kërkimit dhe inovacionit europian, do të mbahet më 29 qershor 2026 në selinë e Këshillit Europian të Kërkimit në Bruksel.

Akademia e Shkencave njofton zhvillimin e simpoziumit ndërkombëtar i cili organizohet nga Këshilli Europian i Kërkimit dhe Akademia Kombëtare Gjermane e Shkencave “Leopoldina”, me mbështetjen e akademive kombëtare të shkencave nga Holanda, Finlanda, Sllovakia dhe Qiproja.

Në qendër të diskutimeve do të jetë koncepti i “Lirisë së Pestë Europiane”, qarkullimi i lirë i dijes, kërkimit shkencor, inovacionit dhe talenteve si një nga shtyllat kryesore për forcimin e konkurrueshmërisë dhe autonomisë strategjike të Europës në një kontekst global gjithnjë e më sfidues, krahas 4 lirive të tjera tradicionale të BE-së : lëvizja e lirë e mallrave, shërbimeve, kapitalit, dhe njerëzve.

Për më shumë info, linku bashkëlidhur:

<https://www.leopoldina.org/.../towards-the-european-fifth...>

## Akademik Nazim Gruda vlerësohet në Greqi me medaljen e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën Hortikulturore (ISHS)



Në kuadër të ceremonisë zyrtare të hapjes së Simpoziumit të 10-të të Evropës Juglindore dhe Lindore për Perimet dhe Pataten, të mbajtur në Kretë, akademikut Nazim Gruda iu akordua medalja e Shoqatës Ndërkombëtare për Shkencën Hortikulturore (International Society for Horticultural Science – ISHS). Ky vlerësim iu dha njëkohësisht edhe prof. Dimitrios Savvas nga Universiteti Bujqësor i Athinës.

Medalja u akordua në shenjë vlerësimi për kontributin e tyre të spikatur në veprimtarinë shkencore ndërkombëtare dhe angazhimin e vazhdueshëm në organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të ISHS. Ky përbën vlerësimin e tretë që akademik Gruda merr nga kjo organizatë ndërkombëtare, pas dy medaljeve të mëparshme të akorduara në Rumani (2023) dhe në Gjermani (2025).

Akademik Gruda është zgjedhur së fundmi edhe kryetar i sektorit “Prodhimi në sera dhe mjedise të kontrolluara” pranë ISHS, si dhe drejton Grupin e Punës për Perimet dhe Pataten në Evropën Juglindore dhe Lindore.

---

Gjatë zhvillimit të simpoziumit në Kretë, ai do të drejtojë workshop-in e FAO-s mbi diversitetin e sistemeve agro-ushqimore, ku do të mbajë ligjërata mbi prodhimin organik dhe sistemet bujqësore rezistente ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe do të kryesojë sesione shkencore mbi përshtatjen e bimëve ndaj stresit abiotik.



## Akademiku Nazim Gruda zgjidhet kryetar i Seksionit për Prodhimin në Sera dhe Mjedise të Kontrolluara të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës



Një arritje e rëndësishme ndërkombëtare i shtohet veprimtarisë shkencore të akademikut shqiptar, Nazim Gruda, i cili është zgjedhur kryetar i Seksionit për Prodhimin në Sera dhe Mjedise të Kontrolluara në kuadër të Shoqatës Ndërkombëtare të Shkencave të Hortikulturës (International Society for Horticultural Science - ISHS). Ky seksion përbën një nga strukturat më të mëdha të kësaj shoqate dhe renditet i dyti për nga numri i anëtarëve.

Zgjedhja në këtë detyrë përfaqëson një vlerësim të lartë për kontributin e vazhdueshëm dhe të spikatur të akademikut Gruda në fushën e hortikulturës moderne, veçanërisht në prodhimin në sera, menaxhimin e mjediseve të kontrolluara dhe zhvillimin e sistemeve të qëndrueshme të kultivimit. Veprimtaria e tij shkencore, e shtrirë ndër vite në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ka ndikuar ndjeshëm në avancimin e praktikave

---

bashkëkohore në këtë sektor.

Shoqata Ndërkombëtare e Shkencave të Hortikulturës (ISHS), me seli në Bruksel, Belgjikë, organizoi së fundmi procesin zgjedhor për drejtuesit e seksioneve të saj shkencore, me pjesëmarrjen e gjerë të anëtarëve nga vende të ndryshme të botës.

Konfirmimi zyrtar i drejtuesve të rinj pritet të bëhet në Kongresin Ndërkombëtar të Hortikulturës (International Horticultural Congress - IHC), i cili do të zhvillohet në muajin gusht në Kioto, Japoni. Në këtë aktivitet prestigjioz, akademiku Gruda është ftuar gjithashtu si ligjërues kryesor (keynote speaker) në një nga simpoziumet shkencore, çka përbën një tjetër tregues të vlerësimit të lartë ndërkombëtar për veprimtarinë e tij.

Marrja e këtij roli drejtues krijon mundësi të reja për forcimin e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar dhe për promovimin e praktikave të avancuara dhe të qëndrueshme në një nga sektorët më dinamikë të bujqësisë moderne.

## Përfaqësueset e Albanian Young Academy në Takimin Evropian të Akademive të të Rinjve në Warsaw



Përfaqësueset e Albanian Young Academy, kryetarja Belfjore Qose dhe anëtarja Jonilda Llupa, morën pjesë në aktivitetet e organizuara në kuadër të Takimit Evropian të Akademive të të Rinjve dhe Asamblesë së Përgjithshme të ALLEA-s dhe ENYA-s në Varshavë.

Gjatë ditës së sotme, ato morën pjesë në aktivitetin "Values in Transition: An Intergenerational Dialogue on Research Assessment Reform", të organizuar nga ALLEA dhe Global Young Academy në kuadër të iniciativës CoARA, si edhe në konferencën

---

publike “Towards a Future of European Research Area: Boosting Trust, Integrity and Resilience”.

Diskutimet u përqendruan në sfidat e reformimit të sistemeve të vlerësimit të kërkimit shkencor, në nevojën për procese më transparente dhe më gjithëpërfshirëse, si edhe në njohjen e diversitetit të kontributeve shkencore dhe trajektoreve akademike.

Një vëmendje e veçantë iu kushtua shmangies së qasjeve të ngushta të vlerësimit të bazuara vetëm në indikatorë sasiorë, duke theksuar rëndësinë e cilësisë, ndikimit real dhe kontekstit të kërkimit shkencor.

Takimet po shërbejnë si një hapësirë e rëndësishme dialogu mbi të ardhmen e kërkimit shkencor në Evropë, integritetin akademik, reformat në vlerësimin e kërkimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet akademive evropiane dhe akademive të të rinjve.

---

**Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Biologjik: ruajtja e tij një përgjegjësi e përbashkët që na lidh në misionin për një të ardhme të sigurt dhe të begatë për çdo gjallesë në Tokë**



Më 22 maj shënohet “Dita Ndërkombëtare e Diversitetit Biologjik”, e caktuar nga Kombet e Bashkuara për të ndërgjegjësuar mbi rëndësinë jetike të biodiversitetit në planetin tonë. Diversiteti biologjik, që përfshin të gjitha format e jetës nga mikroorganizmat te bimët dhe kafshët, është themeli i sistemeve natyrore që na ofrojnë ushqim, ujë të pastër, ajër të freskët dhe mbrojtje ndaj ndryshimeve klimatike. Humbja e vazhdueshme e specieve dhe degradimi i habitateve përbëjnë një rrezik serioz për ekuilibrin ekologjik dhe mirëqenien e njerëzimit.

Biodiversiteti ka rëndësi jo vetëm për mjedisin, por edhe për ekonominë, shëndetin dhe kulturën tonë, sepse na siguron ushqimin dhe mjekësinë natyrore, mbron ekosistemet nga shkatërrimi, ndihmon në përbalimin e krizës klimatike dhe pasuron trashëgiminë shpirtërore të njerëzimit. Ruajtja e tij është një përgjegjësi e përbashkët që na lidh të gjithëve në misionin për një të ardhme të sigurt dhe të begatë për çdo gjallesë në Tokë.

Në këtë kuadër, Akademia e Shkencave e Shqipërisë luan një rol të veçantë përmes projekteve kërkimore që synojnë dokumentimin, mbrojtjen dhe promovimin e biodiversitetit. Nëpërmjet hartografimit, studimeve shkencore dhe bashkëpunimit ndër-institucional, ASHSH kontribuon në ruajtjen e ekosistemeve dhe në ndërgjegjësimin e shoqërisë mbi vlerën e pasurisë natyrore të vendit. Këto iniciativa janë dëshmi e angazhimit institucional për të mbrojtur trashëgiminë biologjike dhe për ta përcjellë atë si një pasuri të pazëvendësueshme për brezat e ardhshëm.

## Dita Ndërkombëtare e Muzeve – hapësira që i shërbejnë zhvillimit të shkencës dhe shoqërisë



Sot është një ditë e veçantë për gjithë komunitetin e muzeve, kombëtarë e ndërkombëtarë. Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM) e themeloi këtë ditë në vitin 1977, me synimin për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi rolin e muzeve në zhvillimin e shoqërisë. Që atëherë, ajo është shndërruar në një traditë globale, ku mijëra muze në mbarë botën organizojnë aktivitete, ekspozita dhe ngjarje që i japin jetë temës së përvitshme të Ditës Ndërkombëtare të Muzeve.

Muzetë nuk janë vetëm hapësira të ruajtjes së trashëgimisë kulturore, por edhe laboratorë të gjallë të dijes, reflektimit dhe dialogut. Në një botë që ndryshon me shpejtësi, ato shtrihen përtej misionit të tyre tradicional: bëhen institucione dinamike që nxisin inovacionin social, përqafojnë teknologjitë e reja dhe krijojnë ura komunikimi me komunitete gjithëpërfshirëse.

Siç theksohet edhe në Rezolutën e ICOM-it “Mbi qëndrueshmërinë dhe zbatimin e Agjendës 2030 – Transformimi i Botës Sonë” (Kioto, 2019), muzetë kanë një rol të pazëvendësueshëm në formësimin e të ardhmeve të qëndrueshme. Ata e realizojnë këtë


---

përmes programeve edukative, ekspozitave tematike, kërkimit shkencor dhe angazhimit të drejtpërdrejtë me komunitetin.

Në këtë kontekst, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka ndërmarrë një fushatë të gjerë për krijimin dhe pasurimin e hapësirave muzeale, si dhe përgatitjen shkencore të profesionistëve të fushës së muzeologjisë. Kjo nismë mbështetet në kompetencat ligjore për trashëgiminë kulturore dhe muzetë në Republikën e Shqipërisë, duke synuar që muzetë të shndërrohen në qendra të gjalla të dijes, kulturës dhe inovacionit.

18 maj, Dita Ndërkombëtare e Muzeve është një kujtesë e fuqishme, sepse muzetë nuk janë thjesht vende ku ruhen objekte, por janë hapësira ku ruhet kujtesa kolektive, ku ndërtohet identiteti kulturor dhe ku frymëzohet e ardhmja e shoqërisë.

## Dita Kombëtare e Drejtësisë



Më 10 maj 1913, qeveria e Ismail Qemalit dekretoi “Kanunin e Zhurisë”, (Kanuni i Jurisë) akti i parë juridik për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor në shtetin e pavarur shqiptar.

Në këtë kanun, si edhe në akte të tjera të kohës, u përcaktuan rregullat themelore për organizimin e drejtësisë në shtetin shqiptar, ndaj kjo datë përkujtohet si Dita Kombëtare e Drejtësisë.

Kjo ditë përfaqëson jo vetëm një moment me rëndësi historike, por edhe një rast reflektimi mbi vlerat e shtetit të së drejtës, të pavarësisë së institucioneve dhe të mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore të qytetarëve.

---

## Urime për ditëlindjet e personaliteteve të shquara të shkencës, kulturës dhe arsimit

Gjatë muajit maj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka përcjellë urimet e saj më të përzemërta për disa prej figurave më të njohura të jetës akademike, shkencore, letrare dhe kulturore shqiptare me rastin e ditëlindjeve të tyre. Nëpërmjet këtyre mesazheve vlerësuese, Akademia ka shprehur mirënjohjen për kontributin e çmuar që këto personalitete kanë dhënë në zhvillimin e shkencës, arsimit, kulturës kombëtare dhe studimeve albanologjike.

Urimet iu drejtuan akademikut Mark Tirta, studiues i shquar i etnologjisë dhe antropologjisë shqiptare; shkrimtarit Koço Kosta, për veprimtarinë e tij letrare; akademikes Kristina Jorgaçi, për kontributin e vyer në fushën e gjuhësisë dhe studimeve letrare; akademikut Sabri Hamiti, një prej figurave më të rëndësishme të letërsisë, kritikës dhe mendimit akademik shqiptar; prof. dr. Seit Mansakut, studiues i njohur i gjuhës shqipe dhe dialektologjisë; si dhe akademikut Anastas Angjeli, me rastin e 70-vjetorit të lindjes, për veprimtarinë e tij të spikatur në fushën e ekonomisë, arsimit të lartë dhe jetës akademike.

Përmes këtyre urimeve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë rikonfirmon respektin dhe vlerësimin e saj për personalitetet që kanë lënë gjurmë të rëndësishme në pasurimin e dijes, kulturës dhe identitetit kombëtar, duke kontribuar në përparimin e shoqërisë shqiptare dhe në promovimin e vlerave shkencore e intelektuale.

---

**In memoria**

---

## Veprimtaria përkujtimore e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë muajit maj

Gjatë muajit maj, Akademia e Shkencave e Shqipërisë përkujtoi figura të shquara të shkencës, kulturës, arsimit dhe historisë shqiptare, duke shënuar përvjetorë lindjesh dhe ndarjesh nga jeta të personaliteteve që kanë dhënë kontribute të rëndësishme në fusha të ndryshme të jetës intelektuale dhe shoqërore. Këto përkujtime u realizuan në kuadër të kalendarit enciklopedik të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Në fushën e shkencës dhe të studimeve akademike u përkujtuan akademikët Salvator Bushati, Kolec Topalli, Gudar Beqiraj, Bardhyl Golemi, Teki Biçoku dhe Vladimir Misja, si edhe studiuesit e profesorët Iliaz Fishta, David Luka, Stefanaq Pollo dhe Anastas Dodi. Këto shkrime sollën në vëmendje kontributet e tyre në zhvillimin e kërkimit shkencor, të arsimit të lartë dhe të institucioneve akademike në Shqipëri.

Një vend të veçantë zuri përkujtimi i Andromaqi Gjergjit, akademikes së parë shqiptare, e njohur për veprimtarinë e saj në fushën e etnologjisë dhe të studimeve kulturore.

Në fushën e letërsisë dhe kulturës u përkujtuan Ernest Koliqi, Nonda Bulka, Haki Stërmilli, Milto Sotir Gurra, Vath Koreshi dhe Mitrush Kuteli, autorë që përfaqësojnë periudha dhe prirje të rëndësishme të zhvillimit të letërsisë shqipe. Gjithashtu u kujtua këngëtari i këngës popullore qytetare shkodrane Shyqyri Alushi, si pjesë e traditës muzikore dhe kulturore shqiptare.

Pjesë e veprimtarisë përkujtimore të muajit ishin edhe figura të njohura të albanologjisë dhe studimeve shqiptare, si Norbert Jokl, Wilfried Fiedler, Alain Ducellier, Franz Nopcsa, Tahir Dizdari dhe Skënder Anamali. Punimet dhe kërkimet e tyre kanë zënë një vend të rëndësishëm në studimin e gjuhës, historisë, arkeologjisë dhe kulturës shqiptare në kontekstin ndërkombëtar.

Në këtë kuadër u përkujtuan gjithashtu Lekë Matrënga, një ndër figurat e hershme të letërsisë arbëreshe, Dom Nikollë Kaçorri, atdhetar dhe nënshkrues i Aktit të Pavarësisë, si dhe akademiku malazez Momir Djurović, anëtar nderi i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Përmes këtyre përkujtimeve, Akademia e Shkencave e Shqipërisë vijoi evidentimin e figurave dhe kontributeve që kanë ndikuar në zhvillimin e shkencës, kulturës dhe mendimit shqiptar, duke i integruar ato në veprimtarinë e saj të komunikimit publik dhe të kujtesës institucionale.

